



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti I Shkencave Shoqërore Bahshkëkohore

Teza e magjistraturës

Tema: Marrëdhëniet diplomatike konsullore mes Kosovës dhe Shqipërisë në
sferën e së drejtës pasurore dhe të së drejtës së autorit

Mentori:
Prof.Dr.Zemri Elezi

Kandidati:
Arbenita Jupolli

Tetovë 2018

PËRMBAJTJA

Përmbajtja.....	1
• Kapitulli I.....	4
1.Hyrje.....	4
1.1 Qasja metodologjike-metodat e hulumtimit.....	4
1.2 Metoda juridike.....	4
1.3 Metoda historike.....	5
1.4 Metoda e analizës.....	5
1.5 Metoda e krahasimit.....	5
• Kapitulli II.....	6
2.Nocioni.....	6
2.1 Lindja e të drejtës së autorit.....	6
2.2 Definicioni mbi të drejtat e autorit e autorit në Republikën e Kosovës dhe në Rep.e Shqipërisë.....	10
2.3 Veprat e autorit dhe kushtet e mbrojtjes.....	14
• Kapitulli III.....	13
3.Ndarja e të drejtave të autorit.....	16
3.1 Të drejtat morale në Kosovë dhe në Shqipëri.....	18
3.2 Të drejtat vetjake jopasurore të autorit.....	20
3.3 Komentet e shërbyesve medial audiovizual dhe artikujt e shtypit.....	23
3.4 Të drejtat morale.....	24
3.5 E drejta në publikimin e veprës.....	25
3.6 Komponentat morale dhe pasurore të së drejtës së autorit.....	26
3.7 E drejta në njohjen e autorësisë.....	28
3.8 E drejta në respektimin e pacenueshmërisë së veprës së autorit.....	28
3.9 E drejta e pendimit-droit de repentir.....	29
• Kapitulli IV.....	31
4.Të drejtat pasurore.....	31
4.1 Kuptimi i të drejtave pasurore të autorit.....	31

4.2 E drejta ekskluzive në shfrytëzimin e veprës.....	33
4.3 Karakteristika e të drejtave pasurore të autorit.....	39
4.4 E drejta në shfrytëzimin e veprës.....	40
4.5 Të drejtat tjera pasurore.....	42
4.6 Kufizimi i të drejtave pasurore në Kosovë.....	44
4.7 Kufizimi i të drejtave pasurore të autorit në Shqipëri.....	46
4.8 Shfrytëzimi i veprës në formë të ndryshuar.....	49
• Kapitulli V.....	50

5.Të drejtat pasurore sipas legjislacionit të Kosovës dhe të

Shqipërisë.....	50
5.1 Dallimet-ngjashmërit e të drejtave pasurore të autorit në Kosovë dhe në Shqipëri	51
5.2 E drejta e shpërndarjes se veprës.....	53
5.2 Përfashtime nga e drejta e qeradhënies dhe huadhënies.....	54
5.3 Përcjellja në publik.....	54
5.4 Ndryshimi i veprës.....	55
5.5 E drejta e vazhdimësis.....	55
5.6 Shfrytëzimi i veprës në formë jolëndore.....	56
5.7 Shfrytëzimi i veprës në formë lëndore.....	56
5.8 E drejta e shpërndarjës.....	57
5.9 E drejta e qeradhënies.....	58
5.10 E drejta e transmetimit në publik.....	58
5.11 E drejta e paraqitjes në publik.....	59
5.12 Transmetimi dhe ritransmetimi i përmbajtjeve programore audiovizuele.....	59
5.13 Programet e koduara.....	60
5.14 E drejta në emetim sekondar.....	60
5.15 E drejta e vënies së veprës në dispozicion të publikut.....	60
5.16 Shfrytëzimi i veprës në formë të ndryshuarë.....	60
5.17 Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë-ZDA.....	61
5.18 Rregullorja për dhënien e lejeve për shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave të autorit.....	62
5.19 Zyra shqiptare për të drejtat e autorit në Shqipëri ZSHDA.....	65

5.20 Detyrat dhe përgjegjësit e ZSHDA-së.....	66
5.21 Të drejtat e autorit në Shqipëri-ndërgjegjësimi.....	68
• Kapitulli VI.....	71
6.Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të autorit.....	71
6.1 Kërkespadia.....	71
6.2 Masat paraprake.....	72
6.3 Masat e përkohshme.....	72
6.4 Sigurimi i provave.....	73
6.5 Cenimi i të drejtave të autorit.....	73
6.6 Mashtrimi për veprat e artit dhe të kultures.....	74
6.7 Shkelja e të drejtave të pronësis industriale.....	75
Shtojcë.....	76
Strategjia kundër falsifikimit dhe piraterisë 2012-2016.....	76
Strategjia për pronësinë intelektuale 2010-2014.....	78
Të drejtat e autorit në bashkimin European.....	79
Përfundimi.....	81
Literatura e shfrytëzuar dhe e konsultuar.....	84

Kapitulli 1

• 1. HYRJE

1.1 Qasja metodologjike - metodat e hulumtimit

Për punimin e një teme të nivelit të tillë gjithmonë kërkohen të përdoren metoda adekuate të cilat do të ndihmonin në rrumbullaksim të idesë e cila lidhet me temën adekuate.

Gjatë punës sime nuk kam përdorur shumë metoda sepse vetë natyra e temës më ka imponuar një gjë të tillë.

Në punimin sa më të mirëfilltë të kësaj teme kam përdorur disa metoda;

-metodën juridike (e njohur edhe si metoda dogmatike);

-metodën historike;

-metodën e analizës dhe

-metodën e krahasimit, (e njohur edhe si metoda komparative).

1.2 Metoda juridike

Metoda kryesore në hulumtimin e kësaj problematike është metoda juridike (dogmatike), e cila është në funksion të kuptuarit të drejtë të domethënjës së normave juridike. Me këtë metodë fitohet pasqyrë e vërtetë për të drejtat autoriale, bazën ligjore e cila është në funksion të kuptuarit të drejtë të normave juridike të miratuara nga institucionet kompetente, në Kosovë dhe në Shqipëri.. Pra me këtë metodë fitohet pasqyrë e vërtetë për ligjet, regullativën ligjore dhe legjislacionin në lëminë e të drejtave autoriale. Megjithatë, vetëm shfrytëzimi i saj nuk siguron sqarim të plotë të lëndës së hulumtimit, prandaj janë përdorur edhe metoda tjera ndihmëse.

1.3 Metoda historike

Metoda historike është metodë ndihmëse e cila ka fushëveprim mjaft të gjërë, ngase përfshinë raporte krahasuese nëpër periudha kohore ku bëhen analiza, zbardhje të fazave të zhvillimit, të niveleve zhvillimore e kështu me radhë. Lirshëm mund të konstatoj se kjo metodë është e përdorur në këtë punim me qëllim që të bëhet analiza e zhvillimit historik të të drejtave autoriale në Kosovë dhe në Shqipëri.

1.4 Metoda e analizës

Metoda e analizës më ka shërbyer për analizën e ligjeve të cilat e rregullojnë lëminë e të drejtave autoriale, si atyre nacionale ashtu edhe direktivave të miratuara në organet kompetente në Kosovë dhe në Shqipëri. Kjo metodë më ka shërbyer për qasje në shpjegimin e ndryshimeve, përshtatjes dhe dallimeve të ligjeve, memorandumëve , udhëzimeve, vendimeve nga Kosova dhe Shqipëria.

1.5 Metoda e krahasimit

Metoda e krahasimit(komparative) më ka shërbyer që gjatë hulumtimit shkencor, të bëjë krahasimin e ligjeve nacionale që e rregullojnë lëmin e lartëpërmendur dhe njëkohësisht të bëjë krahasimin e tyre me direktivat dhe legjislacionin në mes të këtyre dy shteteve Kosovë-Shqipëri. Metoda komparative, veqanarishtë ka qenë në funksion të vështirimit komparativ të mekanizmave dhe instrumenteve që duhet të përdoren në zbatimin e unifikimit të ligjeve nga këto dy shtete.

• 2.NOCIONI

2.1 Lindja e të drejtës së autorit

Ishte shekulli i XVIII që shenon lindjen e të drejtës së autorit. Në atë kohë, përdorimi i veprave që mund të riprodhoheshin lehtësisht, sidomos veprat letrare, nuk paraqisnin problem për autorët. Mjaftonte që të gjenin një editor, t'ia bartnin të drejtat me anë të kontratës, të verifikonin shitjet kohë pas kohe dhe ti merrnin kompensimet mirpo, probleme paraqisnin veprat të cilat mund të interpretoheshin, pra të shfaqëshin në publik, e veqanarisht veprat muzikore dhe ato teatrale, sepse ato mund të interpretohen në vende të ndryshme në distanca shumë të largëta dhe në kohë të njejtë¹. Prandaj menaxhimi i të drejtave në mënyr individuale nga ana e vet autorit ishte gati i pamundur. Për këto arsye është paraqitur nevoja e menaxhimit kolektiv të këtyre të drejtave. Menaxhimi kolektiv i të drejtave të autorit ka filluarë në Francë në vitin 1776, ku shkrimtari dhe filozofi Beaumarchais themelon “Zyren e legjislacionit dramatik”, e cila me vonë do të quhet “Shoqëria e autorëve dhe kompozitorve gramatik”. Edhe në fushën e letërsisë disa vite më vonë përkatsisht në vitin 1873, shkrimtarët Honore de Balzak, Viktor Hygo, Aleksander Dumas dhe shkrimtarë tjerë francezë themelojnë “Shoqërinë e Njerëzve të Letrave”. Këto dy ngjarje i paraprinë edhe krijimt të një shoqërie për menaxhim në fushën e muzikës. Në vitin 1847 dy kompozitor francez Paul Henrion dhe Victor Parizot, si dhe shkrimtari Ernest Bourget, ngrejnë padi kundër Kafe-koncertit “Ambassadesur des Champs-Elysée” në Paris².

Të gjithë klientët duhej të paguanin hyrjen dhe ushqimin në “Ambassadeur” por askujt nuk i shkonte në mëndje të paguante autorët e veprave që luante orkestra. Ata vendosin të shkojnë dhe të mos e paguajnë faturen e ushqimit përderisa ata të mos paguheshin për muzikën e tyre.

¹hpt\\www.menaxhimi kolektiv i të drejtave të autorit.com

²hpt\\www.menaxhimi kolektiv i të drejtave të autorit.com

Gjykata vendosi ne favor të tyre,dhe urdhëroj pronarin e restaurantit të paguaj një shumë të konsiderueshme për autorët.

Kështu në vitin 1851,themelohet edhe ''SACEM'' shoqëria e autorëve,kompozitorëve dhe editorëve të muzikës.Kjo shoqëri do të ketë për vite me radhë një rol shumë të rëndësishëm edhe për vendet tjera,ku kjo shoqëri do të merrej si model për në Itali 1882,në Spanjë 1901,në Gjermani 1933.Pothuajse në të gjitha vendet e botës,autorët filluan të grupohen në shoqëri të menaxhimit kolektiv.

Kështu në vitin 1926 krijohet Konfederata ndërkombëtare e shoqërive të autorëve dhe kompozitorëve që sot numron 232 shoqëri antare nga 121 shtete të ndryshme.Në vitin 1990 shoqërit kryesore të Bashkimit Evropian,të Norvegjisë dhe Zvicrës,krijojnë grupimin evropian të shoqërive të autorëve dhe kompozitorëve e cila sot ka 34 shoqata anëtare.Me zhvillimin e teknologjisë në kohën moderne autorëve ju është bërë edhe më e vështirë menaxhimi i të drejtave sepse e njejta vepër mund të shfaqet me mijëra herë në ditë përmes mjeteve të ndryshme si televizioneve,radiove,internetit⁴ brenda dhe jashtë vendit.Imagjinoni një kompozitor,muzika e të cilit dëgjohet në të gjithë botën se si do të mund të kontaktonte me të gjitha radiot,televizionet,apo diskotekat,baret e restaurantet për të menaxhuar të drejtën e tij.Mirëpo,edhe për një radio ose televizion,i cili i shfrytëzon mijra vepra brenda vitit,do të ishte e pamundur të kontaktonte secilin bartës të së drejtës për të kërkuarë autorizimin për shfrytëzim.Edhe në procesin e negocimit me shfrydzuësit,autori si i vetëm do të ishte në një pozitë të pafavorshëm.Bashkimi i autorëve në një shoqëri, do t'i vendoste ata në një pozitë shumë më të mirë,ku ata do të mund të arrinin përfitime më të mira financiare,por edhe të impononin kushtet e tyre për shfrytëzimin e veprës.Edhe në luftën kundër piratëris,shoqërit e menaxhimit kolektiv janë më të fuqishme dhe mbrojnë interesat e autorit.

Ato bëjnë studime,analiza dhe raporte të cilat i shërbejnë institucioneve për të hartuar politikat e duhura në fushën e të drejtës së autorit.Prandaj ato shihen si partnere të institucioneve si në nivele shtetërore ashtu edhe në ato ndërkombëtare.Menaxhimi kolektiv ka edhe të metat e veta.Autori ,kur i bashkohet një shoqërie e humb lirinë që të vendos se kush da ta shfrydzon veprën e tij. Shfrytëzuesit kontaktojnë direkt shoqërinë kolektive, e cila jep autorizimin pa e pyetur autorin.

⁴ hppt\\www.menaxhimi kolektiv i te drejtav te autorit.com

Gjithashtu, autori nuk mund të caktoj tarifat për shfrydzesit e vepres së vet,sepse kjo bëhet nga shoqëria.

Mirëpo,duhet të kemi parasysh se shoqërit e menaxhimit kolektiv janë shoqërit e autorëve për autorët dhe praktika ka dëshmuar se kur ato janë të organizuara mirë mund të kenë shumë suksese. Për shkak të specifikav që ka industria muzikore,shoqërit e menaxhimit kolektiv në fushën e muzikës janë më të mëdhat dhe më të fuqishmet.Por edhe autorët e fushave tjera kanë shoqërit e tyre në vendet e ndryshme.

Nëse e marim shembull Francën e cila konsiderohet djep i shoqërive kolektive pos autorëve të muzikës, shoqëri të tyre kanë edhe autorët e arteve grafike dhe plastike,arteve vizuele,autorët e multimedias,shkrimtarët,producentët e fonogrameve etj.

Por si mund të definohet menaxhimi kolektiv?

As konventat ndërkombëtare e as ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta i Kosovës nuk e definojnë. Definicioni i për shoqatat kolektive në direktivën e Bashkimit Evropian⁵që i definojnë si organizata që menaxhojnë apo administrojnë të drejtat e autorit apo të drejtat e përafërta.Një definicion të ngjashëm e gjejmë po në këtë direktivë në nenin 4 pika 1.2 mirpo konsiderojmë se ky definicion është mjaftë restriktiv prandaj na mbetet të japim një definicion më të përgjithshëm.Menaxhimi kolektiv i të drejtave bëhet nga shoqërit e menaxhimit kolektiv,që veprimtari primare apo të vetme kanë menaxhimin e të drejtave të autorit apo të drejtave të përafërta të antarëve të saj për llogari të këtyre të fundit.Shoqërit kolektive negociojnë,caktojnë kushtet dhe japin autorizime për shfrytëzim të veprave, mbledhin kompenzimet nga përdoruesit dhe i shpërndajnë ato tek bartësit e së drejtës si dhe kontrollojnë respektimin e marrëveshjeve kontraktuese me shfrytëzuesit.Tani të drejtat e autorit në kohën e sotme konceptohen të përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e subjektit pjesëmarrës në veprimtarinë krijuese, prodhuese, tregtare ose në gjdo veprimtari tjetër vlersimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike apo shkencore⁶.

⁵Direktiva nr 93/83/CEE e Bashkimit Evropian neni 1.4.

⁶ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 1,shpallur ne dekretin nr .4585 Tiranë 2005

Të drejtat e autorit që në bazë të pronës intelektuale u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, të drejtat që në bazë të pronës intelektuale janë të përafërta me të drejtën e autorit⁷.

Zhvillimi historik i së drejtës së autorit në Shqipëri është pëcjellë në disa faza kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shtetit dhe i së drejtës.

Këto faza janë:

I Faza e parë-rregullimi i të drejtës së autorit nga Kodi Civil i vitit 1929,që është edhe një nga aktet më të plota juridike,

II Faza e dytë -1955-1981,

III Faza e tretë-rregullimi nga Kodi Civil i vitit 1982 përkatësisht me nenet 315-318 të kreut të VIII të tij,

IV Faza e katërt 1992-2005.

Faza e parë Kodi Civil i viti 1929 shënon fillimet e para të mbrojtjes së të drejtës së autorit në Shqipëri. E drejta e autorit parashikohej një nga objektet e së drejtës së zotërimit.Kjo e drejtë sanksionohej si e drejtë e autorit dhe e shpikësve mbi veprat dhe shpikjet e tyre.Objekt i këtyre të drejtave quheshin sendet e patrupëzuara⁸.Faza e dytë ,neni 58 i Pjesës së Përgjithshme të Kodit Civil aprovuar me ligj të veçantë sanksiononte mbrojtjen e të drejtës së autorit si një nga të drejtat personale jopasurore.Në zbatim të rregullimit të përgjithshëm të së drejtës së autorit u aprovuan edhe një sërë aktesh nënligjore.Faza e tretë e rregullimit është ajo që i korespondon periudhës kur ishte në fuqi Kodi Civil i vitit 1981.Ndër të drejtat personale jopasurore më të rëndësishme përmendëshin e drejta e autorit dhe e drejta e shpikjes dhe e racionalizimit.

Duke parë përmbajtjen e këtij rregullimi rezulton se për të lindur e drejta e autorit duhet që prodhimi i krijimtarisë intelektuale të materializohet në një formë konkrete,në mënyrë që të mund të përceptohej nga të tjerët pa qenë i nevojshëm publikimi dhe shpërndarja e saj.Faza e katërt fillon në vitin 1992 deri në vitin 2005,ishte baza ligjore ajo që ishte më e rëndësishmja e kësaj periudhe.Baza e re ligjore solli një trajtim të ri të së drejtës së autorit,solli më shumë liri në marrëdhëniet e tij kontraktore me të tretët dhe të ardhura dhe fitime pasurore të liberalizuara nga mekanizimi kërkesë-ofertë⁹.

⁷ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 1 pikat 1.1 dhe 1.2 Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

⁸Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 23,shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

⁹ Vepra e cituar fq.26

2.2 Definicioni mbi të drejtat e autorit në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipëris

E drejta e autorit mund të definohet në kuptimin objektiv dhe në kuptimin subjektiv. E drejta e autorit në kuptimin objektiv përfshinë tërsin e normave juridike me të cilat rregullohen mardhëniet juridike për krijimtarine intelektualë në lëmin e letërsisë, shkencës, artit dhe dispozitat tjera juridike me të cilat rregullohen qështjet që janë në lidhje apo dalin nga produkti intelektual. E drejta e autorit paraqet degën e së drejtës që merret me mbrojtjen e krijuesve¹⁰. E drejta e autorit në kuptimin subjektiv paraqet pushtetin juridik të karakterit absolut lidhur me krijimtarinë intelektuale që ka cilësinë e veprës së autorit. E drejta e autorit është e drejtë personale me karakter absolut. E drejta e autorit së bashku me të drejtën e pronësisë industriale përbëjnë pronësinë intelektuale. Pronësia intelektuale si ajo e të drejtës së autorit ashtu edhe ajo e pronësisë industriale, janë objekt i rregullimit juridik të pavarur. Kjo shprehet sidomos në kohën më të re. Parimisht të gjitha kushtetutat e shteteve garantojnë lirin e krijimtarisë shkencore, kulturore dhe artistike, pastaj garantohej edhe mbrojtja e të drejtave morale dhe materiale (pasurore) që dalin nga krijimtaria shkencore, kulturore artistike, intelektuale dhe krijimtaria tjetër. E drejta e autorit mund të konsiderohet si degë e veçantë e së drejtës sepse ka një mori veqorishë të cilat e dallojnë në raport me degët tjera.

Para së gjithash specifike është mbrojtja e të drejtës morale dhe pasurore të të drejtës së autorit. Vepra për të gëzuarë mbrojtjen e të drejtës së autorit, duhet të paraqitet si produkt intelektual, si rezultat i krijimit shpirtor të personit të caktuar-krijuesit të vepres.

E drejta e autorit përkufizohet si tërsi e normave juridike të cilat rregulloj mardhëniet shoqërore që rrjedhin nga krijimi dhe vlersimi i veprave shkencore, letrare juridike që në krijimin mund të konsiderohet vepër në kuptimin që jep ky përkufizim¹¹.

Duhet të plotëson tri kushte që të mund të kemi një vepër arti:

- a) krijimi duhet të ketë karakterin e një krijimi intelektual të një njeriu ose të një grupi njerëzish;
- b) të jetë e shprehur në një formë konkrete që të mund të kapet nga shqisat e njeriut si dhe të jetë bërë e njohur për njeriun;

¹⁰ Aliu Abdulla Edrejta e Autorit fq 5, Prishtinë 2004

¹¹ http://www.edrejta_e_autorit/esihasko.com

c) krijimi duhet të jetë origjinal nëse kushtet plotësohen atëherë vepra gëzon mbrojtje ligjore panvarsisht nga vlerat e saj.

Regullimi juridik i tyre, jo vetëm që bëhet në mënyrë të pavarur në raport me të drejtat tjera civile por rregullimi i tyre bëhet në mënyrë të pavarur me ligje të veqanta. E drejta e autorit dhe pronësia industriale, kanë bazën e tyre të përbashkët andaj edhe emërohen me emrime të përbashkëta. E drejta e autorit është pushtet absolut që lidhet për krijuesin e produktit intelektual, respektivisht për bartësin e të drejtës së autorit, kjo e drejtë është e mbrojtun me të drejtën nacionale por edhe me atë ndërkombtare¹².

Me Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut 1948 nën 27 alinea 2 thuhet se gjdokush ka të drejtë në mbrojtjen e interesave materjale dhe morale që dalin nga qdo krijimtari shkencore, letrare ose artistike të ndonjë autori.

Kjo përsëritet edhe në shumë akte të tjera juridike ndërkombtare. Pakti Ndërkombtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore 1966 nën 15 alinea 1 thuhet: “shtetet antare të Paktit egzistues i pranojnë gjdokujt të drejtën në fitime nga mbrojtja e interesave materiale dhe morale që dalin nga gjdo krijimtari shkencore, letrare ose artistike të ndonjë autori¹³. Komisioneri i Përkohshëm për Media i Kosovës, për mbrojtjen e nenit 27 të Deklaratës Universale ka nxjerr disopzitat e Licencës së Komisionit të Përkohshëm të mediave KPM për të drejtat e autorit-udhëzimet për zbatim 1 janar 2004.

Kjo fushë e së drejtës në nivelin ndërkombtar është e rregulluar me Konventën e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare e artistike të vitit 1886 të plotsuar dhe ndryshuar shumë herë më vonë e cila konvent e obligon edhe të drejtën tonë, sepse është e ratifikuar dhe në këtë mënyrë është bërë e drejtë e obliguar edhe për ne.

Pastaj Konventa Universale mbi të drejtën e autorit 1952.

Konventat shumëpalëshe ndihmojnë në përcaktimin e të drejtës kompetente etj.

Në Republikën e Kosovës të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta tani rregullohen me ligjin e ri i cili ka hy në fuqi me 21 tetor 2012.

Ky ligj rregullon:

Të drejtat e autorit që në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, dhe artit në vijim e drejta e autorit:

Të drejtat që në bazë të pronës intelektuale, janë të përafërta më të drejtat e autorit në vijim të drejtat e përafërta u takojnë:

¹² Deklarata Universale e të drejtave të njeriut e vitit 1948

¹³ Pakti Ndërkombtar për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore 1966

- Interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre;
- Prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre;
- Producentve të filmit përkitazi me videogramet e tyre;
- Shërbyesit medial Audiovizuel përkitazi me transmetimet e tyre;
- Prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave;
- Botuesve përkitazi me botimet e tyre.

1.3 Administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta

1.4 Mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtav të përafërta

1.5 Zbatimin e këtij ligji ndaj personave të huaj¹⁴.

Masat administrative, inspektimi, mbrojtja juridiko-civile dhe penale të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të procedurës administrative gjyqësore.

1.E drejta e autorit është e drejta e pandashme e një vepre,e cila i takon autorit si subjekt i pronës intelektuale për vepren e mbrojtur.

2.E drejta e autorit përmban:

2.1 Autorizimet ekskluzive personale për të mbrojtur pacenueshmërinë e vepres së autorit dhe personalitetin e autorit, në vijim të drejtat morale te autorit:

2.2 Autorizimet ekskluzive pasurore për të mbrojtur interesat pasurore të autorit në vijim të drejtat pasurore të autorit.

2.3 Autorizimet tjera të autorit në vijim të drejtat tjera të autorit¹⁵.

Tekstet zyrtare, siq janë ligjet dhe dispozitat tjera,vendimet gjyqsore të organeve administrative nuk janë objekt i së drejtës së autorit dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje juridike të autorit.Kjo nuk e ndalon mundsin që me ligj të parashihet edhe diqka tjetër.

Të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të sipas legjislacionit të Shqipërisë.Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta të Shqipëris përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjektit pjesmarrës në veprimtarinë krijuese, prodhuese, tregtare ose në gjdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike apo shkencore¹⁶.

Ky ligj zbatohet për personat fizikë a juridik, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari krijuese, tregtare, prodhuese apo gjdo veprimtari tjetër vlersimi, shfrydzimi, përdorimi a

¹⁴ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 1 ,Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

¹⁵ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 6,Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

¹⁶ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 2,shpallur në dekretin nr.4587 Tiranë 2005

-tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore në territorinë Republikës së Shqipërisë.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

- a) Veprat që nuk janë shfaqur në publik dhe që kanë për autor shtetas shqiptarë;
- b) veprat që nuk janë shfaqur në publik dhe që kanë për autor persona fizik që jetojnë ose janë rezident në Republikën e Shqipërisë;
- c) veprat që janë shfaqur për publikun në Republikën e Shqipërisë ose janë shfaqur për publikun në një vend tjetër dhe brenda 30 ditëve janë shfaqurë në Republikën e Shqipërisë;
- d) veprat e autorve të huaj të shfaqura për herë të parë në vendin e tyre apo në një vend të tretë dhe brenda 30 ditëve janë shfaqur në Republikën e Shqipërisë;
- e) veprat arkitekturore të ndërtuara në territorinë e Republikës Shqipërisë.

Shfaqjet e artistve interpretues ose ekzekutues që jetojnë në Territorin e Republikës së Shqipërisë, të fiksuara në regjistrimet e tingujve, të mbrojtura nga ky ligj, të interpretuara ose të ekzekutuara për herë të parë për publikun e Republikës së Shqipërisë ose të interpretuara ose të ekzekutuara jo më vonë se 30 ditë edhe në Republikën e Shqipërisë.

Regjistrimet e tingujve, të realizuara nga prodhuesit, persona fizik ose juridik që jetojnë ose janë rezident në Republikën e Shqipërisë, kur fiksimi i parë në një formë materiali është prodhuarë për herë të parë në Republikën e Shqipërisë, tashmë të disponueshme për publikun e Republikës së Shqipërisë ose që janë bërë të disponueshme më parë në një vend tjetër dhe në të njëjtën kohë brenda 30 ditëve bëhen të disponueshme edhe në Republikën e Shqipërisë.

Programet radiofonike dhe televizive, të transmetuara nga organizatat e radios dhe televizionit me seli në Republikën e Shqipërisë, të transmetuara nga stacionet e emetimit që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë¹⁷.

-Autori është personi ose janë personat fizikë që krijojnë një veprë letrare, artistike ose shkencore.

-Autori i veprës është gjdo person fizik ose një grup personash fizik, me emrin e të cilit/ve vepra është shfaqur për herë të parë në publik, me përjashtim të rastit kur vërtetohet se autorësia i përket një ose disa personave fizikë të tjerë nga ata që kanë emrat në vepër.

¹⁷Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 3, shpallur në dekretin nr.4587 Tiranë 2005

Në rastet kur vepra është shfaqur anonime ose me pseudonim përpara publikut gjë që nuk lejon identifikimin e autorit, e drejta e autorit do të ushtrohet nga personi fizik a juridik që është përgjegjës për shfaqjen e veprës në publik për aq kohë sa autori nuk e zbulon identitetin. Subjekti i parë dhe më i rëndësishmi i të drejtës së autorit është gjdo autor i veprës. Autori është personi fizik apo grupi i personave që krijojnë një vepër, e cila del me emrin e tij ose të tyre¹⁸. Presumohet si autor i veprës personi ose personat fizik nën emrin e të cilëve ka dalë vepra, në momentin e parë kur është bërë prezent apo është shfaqur për herë të parë në publik, me përjashtim të rastit kur vërtetohet ndryshe. Autor mund të jetë gjdo person fizik që ka zotësi juridike, pavarësisht nëse ka ose jo zotësi për të vepruar.

Personi juridik nuk mund të jetë autor, por i gëzon të drejtat e autorit në rastin kur ai është prodhues ose pronar i veprës në rastin konkret dhe kjo ndodh kur vepra kolektive del nën emrin e tij. Emri i tij në këtë rast është një tregues i të drejtës së pronësisë dhe i faktit që vepra është krijuar prej tij në iniciativën e tij dhe me mjetet e tij financiare, teknike dhe profesionale¹⁹. Kur flasim për autor do të nënkuptojmë gjithmonë egzistencën e një vepre, në kuptimin që sa herë që ka një autor, ka edhe një autorësi. Autorësia është mardhënia juridike që krijohet midis personit fizik që ka bërë punën krijuese dhe vet veprës që është rezultat punës së tij.

2.3 Veprat e autorit dhe kushtet e mbrojtjes

Pronësia intelektuale është e ndarë në dy kategori dhe atë në të drejtën e pronësisë industriale dhe të drejtën e autorit. Pronësia industriale përfshinë patentat, markat tregtare, dizajnin industrial dhe treguesit gjeografik.

E drejta e autorit mbron veprat artistike dhe letrare si novelat, poemat, filmin, veprat, veprat muzikore, veprat artistike si vizatimet, pikturat, fotografitë, skulpturat dhe dizajnin industrial e grafik.

Në këtë punim do të diskutohet vetëm për të drejtën e autorit, konkretisht për veprën e autorit dhe kushtet e mbrojtjes së saj.

¹⁸ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri, fq.28-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

¹⁹Vepra e cituar fq .29

E drejta e autorit është degë e së drejtës që merret me të drejtat intelektuale të krijuesve. Njohja e të drejtave të autorit bëhet për arsye kulturore dhe shoqërore.

Të drejtat e autorit si të drejta ekskluzive, egzistojnë për një periudhë të caktuar kohore, me kalimin e kësaj kohe të përcaktuarveprat e autorit bëjnë pjesën e domenit publik dhe mund të përdoren lirshëm. Në këtë aspekt është me rëndësi të potencohet fakti se zhvillimi i një shteti varet nga kreativiteti i qytetareve të tij²⁰, kjo paraqet një nga shumë arsyet se pse është e rëndësishme e drejta e autorit për vendin tonë. E drejta e autorit i jep të drejtë ekskluzive autorit të veprës së mbrojtur, përjashtimisht duke marrë parasysh kufizimet e parapara ligjore. Qdo here, kur një person i caktuar, përveq autorit të veprës së mbrojtur, dëshiron të përdorë veprën e mbrojtur të autorit, është i obliguar të kërkojë leje nga autori për përdorimin e veprës.

Në bazë të Konventës së Bernës, një ndër konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtën e autorit, veprën e autorit konsiderohet vepra letrare dhe artistike që përfshinë gjdo prodhim të domenit shkencor, letrar dhe artistik në qfardo formë të shprehjes²¹. Ky përkufizim i lejon hapsirë manovruese shteteve antare të Konventës lidhur me përcaktimin se cilat janë veprat e mbrojtura dhe kushtet të cilat duhet një veprë ti plotësojë për të gëzuar mbrojtje.

Kushti i parë për të gëzuar mbrojtje një veprë, është që ajo të jetë e shprehur. Veprat janë të mbrojtura vetëm kur janë të shprehura ndërsa idet janë të përjashtuara nga mbrojtja²². Në bazë të legjislacionit tonë vepra mund të jetë e shprehur në qfardo formë. Në këtë aspekt si shembull vepra muzikore mund të gëzojë mbrojtje juridike edhe nëse nuk është e regjistruar²³ apo e ruajtur. Kushti i dytë për të gëzuar mbrojtje një veprë ajo duhet të jetë krijim intelektual origjinal, origjinaliteti i veprës është element me rëndësi që është ngushtë i ndërlidhur me formën e shprehjes së veprës.

Origjinaliteti i veprës shprehet me veprën si krijim intelektual dhe është nocion subjektiv si shprehje individuale e autorit që është ndërlidhur me personalitetin e autorit.

²⁰ Organizata Botërore e Pronësive Intelektuale, Pronësitë Intelektuale: Politikat, Legjislacioni dhe Përdorimi, Kapitulli 2 Fushat e mbrojtjes së Pronësive Intelektuale.

²¹ Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave Letrare dhe Artistike neni 2, 1886

²² Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 12, ligji nr 04/I-065, 30 Prishtinë 2012

²³ Fjala e regjistruar në këtë punim përdoret për të treguar regjistrimin e veprës në CD, DVD apo mjet tjetër të ruajtjes së veprave muzikore.

• 3. NDARJA E TË DREJTAVE TË AUTORIT

Llojet e të drejtës së autorit:

1. Të drejtat morale dhe

2. Të drejtat pasurore

Lidhur me objektin e mbrojtjes së të drejtës morale të autorit ndër autorët ka dallime. Objekti i mbrojtjes është vepra e autorit si produkt shpirtëror, mendor, ndërsa të drejta pasurore i japin mbrojtje juridike veprës si vlerë materiale e të drejtës personale si vlerë shpirtërore. Objekti mbrojtjes është personaliteti i autorit, e detyrë e të drejtës morale është ta mbrojë ekskluzivisht personalitetin intelektual të autorit të veprës²⁴.

Element kompromisi objekti i të drejtës morale të autorit është jo vetëm personaliteti i autorit por edhe vepra e tij, respektivisht lidhja që egziston në mes të veprës dhe autorit.

Autori ka të drejtë ekskluzive për të vendosur nëse, kur dhe në qfarë mënyre do të publikohet për herë të parë vepra e tij.

Autori ka të drejtë ekskluzive për t'ia komunikuar publikut apo për t'ia përshkruar përmbajtjen e vepres së tij përderisa vepra nuk është bërë e ditur me autorizimin e tij²⁵.

Përmbajtja e të drejtës së autorit përfshinë në vetvete dy grupime të mëdha dhe të rëndësishme të drejtash, që janë të drejtat vetjake jopasurore ose siq quhen ndryshe të drejtat morale dhe të drejtat pasurore ose siq quhen ndryshe në Shqipëri të drejtat ekonomike²⁶, ndërsa simbas Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të i Republikës së Shqipërisë parasheh:

1. Të drejtat vetjake jopasurore dhe

2. Të drejtat pasurore

Të drejtat vetjake jopasurore

Autori i një vepre gëzon të drejtat vetjake jopasurore:

²⁴ Aliu Abdulla E drejta e autorit fq 31, Prishtinë 2004

²⁵ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 17 pikat 1 dhe 2-Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

²⁶ Tutulani-Semini Maiana E drejta e autorit në Shqipëri fq 122-shtëpia botuese Skanderbeg books, Tiranë 2009

- a) Të vendos nëse, në qmënyrë dhe kur vepra e tij do të paraqitet publikut, si dhe vendin ku vepra e tij do të paraqitet për herë të parë në publik;
- b) të kërkoj që ti njihet autorsia mbi veprën, veqanarisht e drejta që emri i tij të shkruhet në kopjet e veprës dhe kur e lejon praktika e sipas traditës ti bashkangjitet veprës kur ajo përmendet publikisht;
- c) të vendos në emrin e kujt do të paraqitet vepra e tij te publiku si dhe të drejtën që të mbetet anonim;
- d) të kërkoj respektimin e tërësisë së veprës dhe të kundërshtojë qdo heqje ose ndryshim, që cenon nderin dhe emrin e tij;
- dh) të tërheqë lejen e shfrydimit të veprës, nëse është e nevojshme duke siguruarë moscenimin e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të titullarve të të drejtës së shfrydimit të veprës të cilat mund të dëmtohen nga ky veprim i autorit;
- f) të kundërshtojë bashkautorësinë e vendosur në mënyrë arbitrare nga të tjerët për qfardo lloj shkakut²⁷.

Legjislacioni i të drejtës së autorit është pjesë e një legjislacioni më të gjerë, i njohur si pronësi intelektuale.

Termi pronësi intelektuale i referohet gjegjësisht krijimeve të mendjës së njëriut. Të drejtat e pronësis intelektuale mbrjonë interesat e krijuesve duke ju dhënë atyre të drejtën e pronës mbi krijimet e tyre²⁸. Dy degët e pronësis intelektuale janë pronësia industriale dhe e drejta e autorit. Pronësia intelektuale zakonisht ndahet në dy degë respektivisht pronësia industriale e cila me gjerë thenë mbron shpikjet dhe e drejta e autorit që mbron veprat letrare dhe artistike. Parimi i gjdo lloj prone është që pronari mund ta përdorë atë ashtu siq ai dëshiron dhe që askush tjetër nuk është i legjitimuar ta përdor pa autorizimin e tij. Të drejtat e mbajtësit të së drejtës së një veprë të mbrojtur, të garantuara me ligje kombëtare, janë normalisht të drejta ekskluzive, për të autorizuar një palë të tretë për të përdorur veprën, subjekti i të drejtave dhe interesave të ligjshëm të të tjerëve.

Ka dy lloj të drejtash në të drejtën e autorit:

1. Të drejtat ekonomike
2. Të drejtat morale

²⁷ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 10, shpallur në dekretin nr. 4587 Tiranë 2005

²⁸ Semini Mariana, Torremans Paul dhe Dedi Mariana - Pronësia Intelektuale, botuar nga shtëpia botuese KRISTALINA-KH, Tiranë 2005

Të drejtave ekonomike lejojnë mbajtësin e të drejtave të përfitojnë shpërblime financiare nga përdorimi i veprës së tij nga të tjerët. Të drejtat morale lejojnë autorin të ndërrmar veprime të caktuara për të ruajtur lidhjen personale midis atij dhe veprës. Shumica e ligjeve të të drejtës së autorit njohin se autori ose mbajtësi i të drejtës ka të drejtën të autorizoj ose të ndaloj veprime të caktuara në lidhje me veprën.

Mbajtësi i të drejtave të një vepre mund të ndaloj ose të autorizoj:

1. Riprodhimin e veprës në forma të ndryshme, siq janë publikimet e printuara dhe regjistrimet e tingujve;
2. Shpërndarjen e kopjeve;
3. Shfaqjen në publik;
4. Transmetimin e tyre në gjdo komunikim;
5. Përkthimin e saj në gjuhën tjetër;
6. Përshtatjen (psh një novelë në skenar).

Sipas ZSHDA-së të drejtat e lidhura me të drejtën e autorit u janë akorduar tre kategorive të përfituesve:

1. Interpretuesve;
2. Prodhuesve të fonogramit;
3. Organizatave transmetuese.

3.1 Të drejtat morale në Shqipëri dhe në Kosovë

E drejta morale e autorit, për nga natyra e saj juridike është ekskluzivisht e drejt absolute e cila vepron erga-omnes. Karakteri absolut i të drejtës morale të autorit është deri diku i kufizuar me rregullat ligjore që rregullojnë raportet e autorit ndaj personave të tretë ashtu edhe ndaj autorëve të tjerë kur janë në pyetje vepra e ngjajshme dhe në rastet kur e kërkon interesi i përgjithshëm. Elementet konstituive të së drejtës morale janë të përcaktuara me personalitetin e autorit andaj janë edhe jo të bartshme në personin tjetër (psh e drejta e njohjes së autorësis dhe të drejtës në espektimin e vepres)²⁹. Në praktinën gjyqësore shqiptare ngatërrohet koncepti i të drejtave morale të autorit me konceptin e dëmit moral.

²⁹ Aliu Abdulla E drejta e autorit fq 32, Prishtinë 2004

Këto dy koncepte mbivendosen me njëri tjetrin vetëm atëherë, kur çënohet personaliteti dhe nderi i autorit ose kur vepra e saj është deformuarë, prishur, keqtrajtuar, në mënyrë që të sjellë cënimin e personaliteti të autorit. E vetmja shkelje e drejtpërdrejtë me dëmin moral lidhet me të drejtën morale të vendosjes së emrit të autores në veprën e riprodhuar dhe me dhënien e lejes për këtë riprodhim³⁰. E drejta morale është e lidhur me personalitetin e autorit dhe kjo e drejtë ka për qëllim themelor mbrojtjen e personalitetit të autorit.

E drejta e autorit ekziston me krijim e veprës dhe autori ka mbrojtje juridike të plotë pa plotësuar ndonjë kusht apo formalitet. E drejta morale e autorit për nga karakteri është absolute, ekskluzive dhe rreptsisht personale dhe sipas rregullës mund të bartet vetëm realizimi i të drejtës morale të autorit.

Të drejtat morale të autoriti ndajmë:

1. Të drejtat e publikimit të veprës;
2. Në njohjen e autorsisë dhe respektimin e veprës dhe personalitetit të autorit;
3. Në të drejtën e pendimit- elemente konstituive të së drejtës morale të autorit.

Pra të drejtat morale të autorit janë që ta publikoj vepren, që të pranohet dhe të theksohet si krijuesi i vepres, e drejta e autorit që ti kundërvihet gjdo deformimi apo ndryshimi të veprës dhe e drejta e autorit të kundërshtoj përdorimin e vepres e cila do të fyente nderin dhe autoritetin e tij. Këto të drejta morale të autorit janë të pabartshme midis të gjallëve, pjesërisht të bartshme në rast ndjekje dhe të pakufizuara në kohë, pra janë të përhershme.

Autori ka të drejtën morale të tërheqë lejen e shfrytëzimit të veprës, duke siguruar moscenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të titullarëve të së drejtës së shfrytëzimit të veprës, të cilat mund të dëmtohen nga ky veprim i autorit³¹, nëse është e nevojshme.

³⁰ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 152-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

³¹ Vepra e cituar fq. 125

Ushtrim i të drejtës jopasurore:

1. Të drejtat vetjake jopasurore nuk përbëjnë objekt dorëheqje;
2. Këto të drejta janë të patjetërsueshme dhe nuk mund të parashkruhen;
3. Pas vdekjes së autorit ushtrimi i të drejtave të përcaktuara në nenin 10 kalohet me anë të trashigimisë në përputhje me legjislacionin civil dhe me dispozitat e këtij ligji³².

Në vendet anglosaksone Ligji mbi të drejtën e autorit nuk përmban rregulla për mbrojtjen e të drejtës morale të autorit, e konsiderojnë si subsidiare në raport me mbrojtjen e të drejtave pasurore duke e rregulluarë tërësisht sferen e shfrytëzimit të veprës së autorit duke i mundësuarë mbrojtje juridike, së pari vetë veprës pastaj krijuesit të saj³³.

Sistemi kontinental i jepë përparsi të drejtës morale në raport me të drejtën pasurore.

3.2 Te drejtat vetjake jopasurore te autorit

Përmbajtja e të drejtës së autorit përfshinë në vetvete dy grupime të mëdha dhe të rëndësishme të drejtash, që janë: të drejtat vetjake jopasurore ose si quhen ndryshe të drejtat morale dhe të drejtat pasurore ose si quhen ndryshe të drejtat ekonomike.

Autori i një vepre gëzon të drejtat vetjake jopasurore:

- a) të vendosë emrin e tij në vepër apo në cdo kopje të saj;
- b) të kërkojë që t'i njihet cilesimi i tij, si autor i veprës;
- c) të përcaktojë në emrin e kujt do të prezantohet vepra e tij te publiku që e drejta e autorit të qëndrojë anonim;
- d) të vendosë, nëse vepra e tij do t'i paraqitet publikut, kur do t'i paraqitet, në c'mënyre do
- e) të bëhet kjo gjë, si dhe vendin ku vepra e tij/saj prezantohet për herë të parë në publik;
- f) të kërkojë respektimin e tërësisë së veprës dhe të kundërshtojë c'do heqje apo ndryshim që cenon nderin dhe emrin e tij³⁴;

³² Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 11, shpallur në dekretin nr. 4587 Tiranë 2005

³³ Aliu Abdulla E drejta e autorit fq 32, Prishtinë 2004

³⁴ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 122, shtëpia botuese Skanderbag boos Tiranë 2009

Ashtu siq ka të drejtë të vendosë emrin në vepër dhe të vendosë fatin për tërsinë e saj apo të pjesëve, autori vendos edhe kur e tërheq vepren nga publikimi apo e ndryshon atë, shkëput pjesen nga e tëra, e ndan veprën në pjesë, madje edhe kur e shkatërron atë pjesërisht apo krejtësisht.

Autori ka te drejten morale të tërheqë lejen e shfrytëzimit të veprës, duke siguruar moscenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të titullareve të së drejte së shfrytëzimit të vepres, të cilat mund të dëmtohen nga ky veprim i autorit.

Autori ka të drejtë të kërkojë respektimin e tërsisë së veprës dhe të kundërshtojë çdo heqje apo ndryshim që cenon nderin dhe emrin e tij. Autori ka të drejtë të kërkojë respektimin e tërsisë së veprës dhe të kundërshtojë çdo heqje apo ndryshim që cenon nderin dhe emrin e tij.

Karakteristikat dalluese të të drejtave vetjake jopasurore janë:

Të drejtat vetjake jopasurore janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me autorin, kur ai është gjallë, por edhe pas vdekjes së tij. Vetëm një pjesë e tyre kalojnë me trashëgimi tek trashëgimtarët e autorit³⁵. Kështu e drejta e emrit, e paraqitjes në publik me pseudonim, e bashkeautorësisë, janë të drejta vetjake jopasurore që nuk kalojnë me trashëgimi. Ato janë të lidhura me konceptin e autorit, pavarësisht, nëse ai është gjallë, ka vdekur, apo veprës i ka skaduar edhe afati i mbrojtjes ligjore të saj. Ndërsa të drejta të tilla jopasurore që përmbledhen me konceptin e shmangies së shkeljes së një të drejte personale jopasurore, i kalojnë trashëgimtarëve. Të tilla mund të përmendim: e drejta e kundërshtimit të bashkautorësisë, e drejta e shtremberimit të emrit, e drejta për të vendosur nëse vepra do t'i dalë publikut ose jo, e të tjera³⁶. Edhe praktika ndërkombetare njihet rastet të tilla, që kryesisht u referohen ditareve, që kanë brenda vetës edhe elemente të jetes private të figurave të ndryshme:

Autori nuk mund të heqë dorë nga të drejtat vetjake jopasurore. Të drejtat vetjake jopasurore nuk mund të tjetërsohen.

Autori mund të kryejë veprime juridike apo të lidhë kontrata që lidhen me të drejtat vetjake jopasurore, por jo të natyrës së transferimit, apo kalimit të pronësisë, apo të të drejtave të tjera posedimore.

³⁵ <http://www.te.drejtatvetjakejopasurore.com>

³⁶ Tutulani-Semani Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq.129-shtëpia botuese Skangerbeg books Tiranë 2009

Pas vdekjes së autorit, ushtrimi i të drejtave të Nenit 10, kalon me anë të trashegimisë, në përputhje me legjislacionin civil dhe dispozitat e ligjit.

- A kanë të drejta artistet interpretues dhe ekzekutues?

Aktoret, këngëtarët, muzikantët, valltarët dhe personat e tjerë që prezantojnë, këndojnë, kërcëjnë, recitojnë, luajnë, shfaqen në drama, filma, që drejtojnë një orkestër, ose shfaqin në cdo lloj mënyre një krijim artistik ose letrar, një shfaqje të cdo lloji, duke përfshirë folklorin, varietën, cirkun dhe kukullat, të cilët, në ekzekutimin e një vepre dramatike, letrare apo muzikore ose të një kompozimi, luajnë një rol të rëndësishëm edhe nëse është rolë mbështetës³⁷. Po ashtu, edhe drejtuesit e një orkestre ose kori gëzojnë një mbrojtje të posaqme nga ligji, për të drejtën e autorit.

Drejtuesit e një orkestre ose të një kori, të drejtat autoriale të tyre rregullohen me dispozitat ligjore të ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të nga Republika e Shqipërisë.

Në nenin 53 të ligjit sanksionohen të Drejtat jopasurore të Artistëve Interpretues dhe Ekzekutues të cilat janë:³⁸a) e drejta të kenë emrat e tyre të përmendur, kur shfaqjet e tyre shpërndahen, transmetohen ose fiksohen në mënyrë të paligjshme në ndonjë regjistrim fonografik, film kinematografik ose mbajtës tjetër të veprave të tjera audiovizuale, ose cdo prodhim tjetër të ngjashëm; e drejta për të mbrojtur respektin e cilsisë së shfaqjes dhe të kundërshtojnë cdo ndryshim, fallsifikim. Te drejtat pasurore të Artistëve Interpretues dhe Ekzekutues kanë një status të përcaktuar nga ligji.

Pavarësisht nga ndonjë shpërblim që mund të përfitojnë për interpretimet ose ekzekutimet e tyre të drejtpërdrejta, artistet interpretues dhe ekzekutues gëzojnë të drejtën ekskluzive:

- a) të autorizojnë regjistrimin e interpretimit ose ekzekutimit të tyre;
- b) Të autorizojnë riprodhimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të regjistrimeve të ekzekutimit të tyre;
- c) Të autorizojnë ose të ndalojnë transmetimin me cdo mjet kabllor ose satelitor dhe përcjelljen në publik të interpretimeve ose ekzekutimeve të tyre, përveç kur interpretimi është tashmë i transmetuar ose është bërë nga një fiksim. Në qoftë se regjistrimi përbehet nga një regjistrim fonografik ose i ngjashëm me të, i përdorur për qëllime fitimi ose jo.

³⁷ Tutulani-Semani Mariana Drejta e autorit në Shqipëri fq 132-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

³⁸ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 53, shpallur në dekretin nr.4587 Tiranë 2005

Artistet interpretues ose ekzekutues do të përfitojnë shpërblimin të bazuar në nenin 102 të këtij ligji;

d)Të autorizojë shpërndarjen e regjistrimeve të shfaqjeve të tyre, nëpërmjet shitjes, qeradhënies ose qdo formë tjetër të kalimit të pronësise ose posedimit; e drejta e shpërndarjes së kopjes origjinale të regjistrimit të interpretimit apo ekzekutimit, përveq qeradhënies, shuhet pas shitjes së parë të saj nga titullari i te drejtes ose me miratimin e tij.

e)Të autorizojë venien në dispozicion të publikut ose bërjen e disponueshme për ate, të regjistrimeve, të interpretimeve ose ekzekutimeve të tyre.Artistët interpretues dhe ekzekutues gëzojnë të drejtën e një shpërblimi të drejte dhe të vetem, të pagueshem nga perdoruesi, nese regjistrimi i interpretimit dhe ekzekutimit të tyre është përcjelle ne publik për qellime tregtare, ose riprodhimi i regjistrimit është berë me qellim të transmetimit të tij me mjete apo pajisje me ose pa tel, të afta për t'i përcjellë në publik³⁹.

3.3 Komentet e shërbyesve medial audiovizual dhe artikujt e shtypit

Pas pagesës përkatëse,duhet të jetë e lejueshme riprodhimi nga ana e shtypit,komunikimi i publikut apo vënia në dispozicion e artikujve të publikuar mbi temat aktuale ekonomike,publike apo fetare,apo të veprave të transmetuara,ose temave të tjera të karakterit të njëjtë,përveq nëse përdorimi i tillë është shprehimisht i rezervuarë nga bartësi i të drejtës⁴⁰.

Emërtimi i veprës nga fonogramet e botuara i lejohet transmetuesit me kusht që para emërimit me Shoqatën Kolektive të ketë lidhur kontratë për lartësinë,mënyrën dhe afatin e pagesës së kompenzimit.

Librat e leximit dhe tekstet shkollore

Me pagesë të kompenzimit përkatës është i lejueshëm riprodhimi dhe marrja e pjesëve të shkëputura të veprës së publikuarë të autorit,respektivisht i veprave të publikuara veq e veq nga lëmi i arteve figurative,fotografisë,arkitekturës,arteve aplikative dhe dizajnit -

³⁹ <http://www.te.drejtat.vetijake.jopasurore.com>

⁴⁰ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 57, Ligji nr 04/L-065, 30 Prishtinë 2012

industrial, si dhe i kartografisë ,në libra leximi dhe tekstet shkollore që përmbajnë vepra të më shumë autorëve dhe që i dedikohen mësimdhënies në shkollat e të gjitha niveleve⁴¹.

3.4 Të drejtat morale

Në këto të drejta përfshihet e drejta e publikimit e cila është e drejtë për të vendosur nëse duhet të dalë në dritë përpara publikut një vepër apo të mbahet e fshehur në sferën private si dhe e drejta për të vendosur në lidhje me rrethanat e publikimit si psh koha, vendi dhe mënyra e publikimit, së dyti të drejtat morale përfshijnë të ashtëquajturën të drejtën e emrit e autorësis në tri aspekte e drejta për të kërkuar që të shkruhet emri i autorit në gjdo kopje të veprës ose në rastin kur vepra shfrytëzohet në formë të paprekshme, këti shfrytëzimi të bashkangjitet edhe emri i autorit psh autorët e fotografive. Kur transmetohet muzika në radio emrat e kompozitorëve duhet të përmenden pasi të ketë mbaruar programi dhe kjo nuk përcaktohet në ndonjë mënyrë të veçantë me ligj. Aspekti tjetër është e drejta e autorit për të zgjedhur pseudonimin në vend të emrit të tij si dhe e drejta për të qëndruar anonim, përveç të drejtës së autorësis edhe e drejta e integritetit të veprës kështu një autor mund të kundërshtoj gjdo heqje ose ndryshim të veprës ose konteksti i cili ndryshon përshtypjen që të le vepra. Të drejtën për të tërhequr lejen e shfrytëzimit të veprës në mënyrë të njëanshme duke përfshirë dhe të drejtat individuale të shfrytëzimit nga titullari i të drejtave përkatëse të shfrytëzimit por nëse bëhet një gjë e tillë duhet siguruar që titullari i të drejtave të mos vuaj nga asnjë cenim.

Kjo e drejtë e ndihmon autorin sidomos në rastin kur ai ka kaluar të drejtat shfrytëzimit një botuesi dhe dëshiron të botohet vepra por nuk respektohen të drejtat e autorit ka të drejtë të kërkojë kthimin e të drejtës në mënyrë që të ofroj këto të drejta një botuesi tjetër. Autori duhet të dëmshpërblejë pronarin e të drejtave të shfrytëzimit të cilat ia heq të drejtat e shfrytëzimit kur ai pronar ka bërë investime për një botim të ri⁴².

Autori ka të drejtë ekskluzive të kundërshtojë qfarido deformim apo intervenim tjetër në veprën e tij si dhe qfarido shfrytëzimi të veprës së tij, nëse një ndërhyrje e tillë mund të paragjykonte reputacionin e tij kreativ dhe respektin⁴³.

⁴¹ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 56, Ligji nr 04/L-065, 30 Prishtinë 2012

⁴² <http://www.e-drejta-e-autorit/esi-hasko.com>

⁴³ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 19, Ligji nr 04/L-065, 30 Prishtinë 2012

Autori ka të drejtën e ruajtjes së integritetit të veprës së autorit apo gjdo ndryshim tjetër të veprës së tij si dhe qfardo përdorimi tjetër të veprës që do të cenonte autoritetin dhe nderin e tij,kështu mbrohet vepra e autorit dhe personaliteti i tij nga personat e tretë.Vetëm autori është i autorizuarë që të bëjë ndryshime në vepren e tij apo të bëjë modifikime në vepren e tij andaj edhe nuk mund të konsiderohet që vepra e autorit është definitivisht e kryer ngaqë autori ka të drejtë ta ndryshoj,përpunoj dhe ta përfeksionojë veprën e tij ashtu siq ai vet e parasheh në mënyrën me të mirë.Nëse vepra është në periudhen e botimit ,andaj edhe botimi i veprës do të shkaktonte shpenzime të mëdha për botuesin si dhe autori nuk mund të bëjë ndryshime të veprës pa pajtimin e botuesit mirpo nëse i shtyen ka obligime që botuesit t'ia kompenzoj botimin⁴⁴ .

3.5 E drejta në publikimin e veprës

E drejta e autorit që të vendos se a do ta publikoj veprën apo jo ,dhe në qfarë forme,në qfarë mënyre apo në ndonjë mënyrë tjetër a do t'ia ekspozoj publikut,paraqet një autorizim moral themelor të autorit.Nëse autori nuk dëshiron ta publikoj veprën e tij,askush nuk mund ta detyroj atë.Autori ka të drejtë ta ndërroj mendimin në pikpamje të veprës për publikimin e së cilës ka dhënë pajtimin,dhe të ndërmar veprime juridike të caktuara. Me të drejtën në publikimin e veprës nuk mbrohen vetëm interesat morale,por edhe ato pasurore ngaqë e drejta e publikimit të veprës është në lidhje të ngusht me shfrydizimin e saj dhe paraqet supozim për eksploatimin e autorizimeve pasurore-juridike.E drejta në publikim është e përmbajtur në të drejtën e shfrydizimit të veprës ,gjegjësisht publikimin e veprës dhe krahas komponenteve morale ka edhe ato jo pasurore.Me publikim të veprës nënkuptohet vepra e krijuar,e gatshme për publik.Mënyra e publikimit të veprës varet nga lloji.Disa vepra publikohen që të bëhen të gatshme për publik,të tjerat që të emëtohen,të tregohen etj,andaj me publikimin të vepres nënkuptohen të gjitha format e njoftimit publik të veprës si dhe mënyrat tjera të njoftimit publik.

Publikimi i veprës mund të përfshijë vetëm botimin e veprës pamarparasyshë mënyren me të cilën veprat janë botuarë dhe në këtë rast kemi kuptimin e publikimit të veprës në kuptim të ngushtë, të pranuarë në Konventën e Bernës⁴⁵.

⁴⁴ Aliu Abdulla E drejta e autorit fq 30,Prishtinë 2004

⁴⁵ Vepra e cituar fq.33

Përcjellja në publik:

Përbëjnë veprime të përcjelljës së veprës në publik:

a)shfaqja skenike,recitimi dhe gjdo paraqitje gojore e ekzekutimit para publikut,i veprave dramatike,dramatik-muzikore,letrare a muzikore,nëpërmjet qfarëdo lloji,mjeti a procedimi.

b)shfaqja në publik e veprave kinematografike dhe veprave të tjera audiovizuele.

c)përcjellja e qfarëdo lloj vepre përmes radiopërhapjes ose me qfarëdo mënyre,që shërben për përhapjen pa linjë të shenjave,tingujve ose pamjeve.

d)radiopërhapja ose përcjellja në publik me satelit e qfardo llojë vepëre,nën kontrollin dhe përgjegjësië e organizatës së radiopërhapjes ose të satelitit,të destinuara për tu kapur nga publiku.

e)transmetimi në publik i qfarëdo lloj vepre me tel,rrjet kabllor,fibër optike ose qdo mënyre tjetër,që mundson ose jo shpërblimin.

f) emetimi ose transmetimi,në një vend të hapur për publikun,me anë të qfardo lloj mjeti të përshtatshëm,i veprës së përhapur përmes radios.

g)ekspozimi publik i veprave të artit ose i riprodhimeve të tyre.

h)përcjellja ose hapja e bazës së të dhënave,duke i bërë të disponueshme për publikun,nëpërmjet mënyrave të mësipërme,panvarësisht nëse kjo bazë përmban dhe ose është vepër e mbrojtur⁴⁶.Nuk vlerësohet si përcjellje në publik përcjellja që ndodh brenda rrethit të ngushtë familjar dhe që nuk integrohet e as lidhet me një rrjetë përhapjeje të gjdo lloj natyre.

3.6 Komponentat morale dhe pasurore të së drejtës së autorit

E drejta e autorit i njeh krijuesit të veprës së autorit disa të drejta të caktuara.Ndryshe,të drejtat e tilla të autorit hyjnë në grupin e të drejtave subjektive civile që i karakterizojnë pushteti –autorizimi i titullarit që të njëjtat ti shfrytëzojë dhe disponoj,e që karakteristike e përbashkët e të cilave është qarkullueshmëria –bartja e të drejtave subjektive civile.

Në këtë kuptim bartja-qarkullueshmëria është karakteristik e përbashkët edhe e të drejtave të autorit të cilat burojnë nga veprat e autorit.

⁴⁶ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 16,shpallur në dekretin nr.4587 Tiranë 2005

Megjithatë në të drejtën e autorit duhet të bëhet dallimi ndërmjet komponentit moral dhe komponentit pasuror të të drejtave në veprën e autorit. Komponenti moral përbëhet nga të drejta morale-personale të autorit të cilat i njihën vetëm autorit dhe të cilat nuk mund të jenë subjekt i bartjes ose qarkullueshmërisë juridike, gjegjësisht të njëjtat janë të lidhura me personalitetin e autorit dhe rrjedhimisht nuk mund të jenë lëndë e kontratave të autorit si psh e drejta e shënimit si autor i veprës dhe i njohjes së autorsisë, e drejta e respektimit të pacenueshmërisë së veprës së autorit, e drejta e pendimit-ndryshimit të veprës së autorit e të ngjashme.

Komponenti pasuror i veprës së autorit përbëhet nga e drejta e autorit që ta shfrydzoj dhe eksploatoj ekonomikisht veprën e autorit e që të njëjtat mund të jenë subjekt i qarkullueshmërisë juridike dhe atë qoftë për të gjallë të autorit (bartja përmes kontratave të autorit), ose pas vdekjes së autorit (bartja në trashigimtarë të autorit qoftë sipas ligjit për trashigiminë, ose me testament). Rregullat ligjore në disa raste paraqesin kufizimin në pikpamje të realizimit të autorizimeve morale të veprave të autorit të krijuara në mardhënie punë. Realizimi i disa autorizimeve morale i bashkon vendet të cilat e kanë pranuarë sistemin kontinental ku është i përfaqësuar kuptimi për mospërcaktimin e të drejtës morale. Disa autorizime të veqanta morale shuhën në jetën e autorit ngaqë përnga natyra e tyre janë të pabartëshme nga personaliteti i autorit. Në të drejtën tonë si në sistemin kontinental të drejtat morale zgjasin edhe pas kalimit të afatit të të drejtave pasurore, andaj mund të thuhet që ato janë të paparashkrueshme⁴⁷. E drejta e autorit që të vendos a të publikoj veprën apo jo, dhe në qfarë forme, në qfarë mënyre apo në ndonjë mënyrë tjetër a do t'ja ekspozojë publikut, paraqet një autorizim moral themelor të autorit. Nëse autori nuk dëshiron ta publikoj veprën e tij, askush nuk mund ta detyroj atë. Autori ka të drejtë ta ndërroj mendimin në pikpamje të veprës për publikimin e së cilës ka dhënë pajtimin, dhe të ndërmarë veprime juridike të caktuara.

E drejta e publikimit të parë:

1. Autori ka të drejtë ekskluzive për të vendosur nëse, kur dhe qfarë mënyre do të publikohet për herë të parë vepra e tij.
2. Autori ka të drejtë ekskluzive për t'ia komunikuarë publikut apo për t'ia përshkuarë përmbajtjen e veprës së tij përderisa vepra nuk është bërë e ditur me autorizimin e tij⁴⁸.

⁴⁷ Aliu Abdulla E drejta e autorit fq 33, Prishtinë 2004

⁴⁸ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 17, Ligji nr 04/L-065, 30 Prishtinë 2012

3.7 E drejta në njohjen e autorësisë

Autorizimi themelor moralo-juridik që rrjedh nga postulati i përgjithshëm i pranuarë i të drejtës së autorit, konsiderohet versioni që veprën të cilën e ka krijuar, është e drejtë e autorit që ta shenoj në emer të tij (emri, mbiemri, vetëm mbiemrin, pseodenimin apo ndonjë simbol tjetër ose shenjë të njojes së tij).

E drejta në njohjen e autorësisë përbëhet pre tri komponenteve:

1. Nga e drejta e autorit që ta shenoj veprën e tij dhe të kërkoj nga personat që e shfrytëzojnë veprën e tij në bazë të kontratës apo ligjit, që vepra të shenohet në emër të tij.
2. Nga e drejta e autorit që të ndaloj keqpërdorimin e emrit të tij me qfardo qëllimi.
3. Nga e drejta e autorit që të ndaloj që ti kundërvihet uzurpimit apo moslejtimit të marrjes së veprës së tij. E drejta e autorit që të ndaloj keqpërdorimin e emrit të tij quhet e drejtë negative e autorit. Keqpërdorimi mund të përbëhet nga mosshenimi i emrit të autorit në vepër, nga vënja e emrit të autorit në vepren të cilën nuk e ka kryer, dhe me shenimin e veprës së personit në emër të personit tjetër. Mbrojtja e të drejtës në njohjen e autorësisë njohin të gjitha ligjet nacionale si dhe konventat ndërkombëtare.

Në të drejtën tonë parashihet që të gjithë personat të cilët shfrytëzojnë veprat e autorit: botuesit, përpunuesit, përkthyesit, xhiruesit, si dhe gjdo person tjetër i cili publikisht e shfrytëzon vepren e autorit janë të obliguarë të shenojnë emrin dhe mbiemrin e veprës së autorit. Nëse ata nuk e kryejn këtë detyrim, autori ka të drejtë që në rrugë gjyqësore të realizoj të drejtën e tij⁴⁹.

3.8 E drejta në respektimin e pacenueshmërisë së veprës së autorit

Autori ka të drejtë që të kundërshtojë qdo deformim apo gjdo ndryshim të veprës së tij, si dhe qfardo përdorim tjetër të veprës që do të cenonte autoritetin dhe nderin e tij.

Kështu mbrohet vepra e autorit dhe personalitetin e tij nga personat e tretë. Vetëm autori është i autorizuar që të bëjë ndryshime në veprën e tij apo të bejë modifikimin e veprës së tij, andaj edhe nuk mund të konsiderohet që vepra e autorit është definitivisht e kryer, ngaqë autori ka të drejtë të ndryshojë, përpunoj dhe përfeksionoi veprën e tij.

⁴⁹ Aliu Abdulla E drejta e autorit fq35, Prishtinë 2004

Nëse vepëra është në periudhë të botimit, andaj edhe botimi i veprës do të shkaktonte shpenzime të mëdha për botuesin, si dhe autori nuk mund të bëjë ndryshime të veprës, pa pajtimin e botuesit, mirpo nëse i shtyen, ka për obligim që botuesit t'ia kompenzoj botimin. E drejta në respektimin e integritetit të veprës së autorit në praktik më shpesh ka të bëjë me të drejtën në reprodukimin⁵⁰ e veprës dhe të drejtës në përshtatjen e veprës.

Kur është fjala për reprodukimin e veprës pavarësisht mënyrës e reprodukimit të veprës personi i cili bënë reprodukimin nuk ka të drejtë të bëjë ndonjë ndryshim, dhe është i detyruar ta respektoj integritetin e saj.

Për gjdo ndryshim eventual duhet të muret pajtimi nga autori. E drejta në përshtatjen e veprës nënkupton ndryshimin e veprës, me qëllim të krijimit të veprës së re të autorit të llojit tjetër. Autori i përshtatjes ka liri më të madhe se sa personi i cili kryen reprodukimin e veprës.

Pronari i veprës në rastin e shfrydimit dhe disponimit të veprës, duhet të respektoj të drejtën e autorit: nuk mund ta ndryshoj veprën, ta përpunoj, ta reprodukoj, pa pajtimin e autorit pra duhet ta respektoj integritetin e veprës edhe pse është pronar.

3.9 E drejta e pendimit-droit de repentir

Autori ka të drejtën që veprën të cilën e ka krijuar ta ndryshojë, ta tërheq nga tregu e po ashtu edhe plotësisht ta asgjësoj. Këto autorizime morale rrjedhin nga e drejta e autorit si krijues i veprës që të vendos për fatin e veprës së tij.

Arsyet mund të jenë të ndryshme: ndryshimi i ideve të autorit, krijimi i rrethanave të reja, dhe rrethanat e tjera që mund të jenë të natyrës subjektive apo objektive.

E drejta e pendimit konsiston në dy autorizime të autorit:

- që ta tërheq veprën nga tregu dhe
- të bëjë ndryshime në veprën e publikuar.

Konventat ndërkombëtare si Konventa e Bernës dhe Konventa Universale⁵¹, mbi të drejtën e autorit nuk parashohin të drejtën e pendimit⁵², sikur edhe vendet e të drejtës anglo-saksone. Megjithatë është paraparë në ligjet e disa vendeve antare të Unionit të Bernës (Franca, Gjermania, Polonia, Italia etj).

⁵⁰ Reprodukim-shumëim

⁵¹ Konventa Universale e të drejtave të njeriut 1948

⁵² Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike 1886

Ndërsa në të drejtën tonë, ligji paraqet vetëm një kusht që autori të mund të shfrytëzoj të drejtën e pendimit, shfrydzimi i veprës, që autori e tërheq nga tregu duhet të jetë i atillë që me të të mund ti shkaktohet dëmi autoritetit shkencor apo artistik të autorit.

Një autorizim i tillë përfshin dy të drejta:

-E drejta në kryerjen e ndryshimeve në vetë veprën e kryer dhe

-E drejta e tërheqjes së veprës që me pajtimin e tij është në treg.

Kjo e drejtë është pasojë logjike e të drejtës së publikimit dhe në lidhje të ngushtë me të drejtën e autorit në pacenueshmërinë e veprës dhe ruajtjes së nderit dhe të autoritetit të autorit. Në shumicën e vendeve, në rregullat ligjore që parashohin të drejtën e pendimit, nuk përcaktojnë kurfarë fakti për zbatimin e kësaj të drejte (gjermane, franeze, belge).

Kjo është e drejtë diskrecionale e autorit në lidhje me të drejtën e pendimit.

Në praktik mund të krijohen tri situata:

-Kur autori ka lidhur kontratën e shfrydzimit të veprës.

-Kontratën për bartjen e veprës në personin e tretë.

-Kontrata për veprën e ardhshme.

Kur autori ka lidhur kontratën për shfrytëzimin e veprës, ai ka plotësisht të drejtë pendimit me obligim të dëmshpërblimit për shfrydzimin e veprës.

Ligji ynë nuk e rregullon lidhjen e kontratës për veprën e ardhshme në mes të autorit dhe personit të tretë.

Të drejtën e pendimit e ka vetëm autori, kjo do të thotë se asnjë tjetër prej bartësve të së drejtës së autorit nuk e ka sipas ligjit të trashigimisë apo kontratës të drejtën ta tërheq veprën prej tregu⁵³.

⁵³ http://www.te_drejtat_e_autorit.com

• 4.TË DREJTAT PASURORE

4.1 Kuptimi i të drejtave pasurore të autorit

Në periudhën e së drejtës romake njihet autorësia mbi një krijim vetëm në kuptimin jopasurordhe nga ana tjetër,njihet e drejta e pronësisë mbi krijimin,ndërsa e drejta e autorit si një tërsi normash e rregullash juridike morale dhe ekonomike nuk njihet.Vetëm pas zbulimit të shtypi në mesjetë,kur filluan për herë të parë të materializoheshin dh të shpërndaheshin veprat e krijimtarisë intelektuale ,lindi dhe ideja e nxjerrejs se përfitimeve pasurore,sepse në këtë periudhë filluan të bëheshinevidente edhe të ardhurat që krijoheshin në fushën e botimeve,kryesisht të librave dhe të teksteve.

Karakteristikë e kësaj peridhe ishte se të ardhurat e realizuara nga një veper nuk u jepeshin autorëve apo krijuesve të veprave,por botuesve,librarive dhe pronarëve të shtypshkronjave⁵⁴.Në mbarim të shekullit të 18-të,autorë u ndërgjegjësuat për të drejtat pasurore të tyre si rezultat i ndërthurjes së autorësisëme komercjalizimin dhe për herë të parë drejta e autorit u njoh dhe u rregullua me ligj,veqanarishtë e drejta e autorëve dhe e krijuesve për të tërhequr përfitime materiale nga krijimet e tyre.

Të drejtat pasurore janë të drejta të veqanta të së drejtës së autorit.Ato bëjnë pjesë në grupin e të drejtave të bartëshme dhe në kohë të kufizuara. Autori,duke shfrytëzuar të drejtën e tij pasurore,siguron respektimin e interesave materiale juridike dhe personale juridike,ngaqë ato janë të pandashme,të lidhura dhe në tërsi përbëjnë të drejtën subjektive të autorit.Një nga shembujt kur më së shpeshti vije në shprehje lidhmëria e të drejtës morale dhe pasurore të autorit është tek publikimi i veprës.Botimi,publikimi është një nga mënyrat e shfrytzimit ekonomik të veprës së autorit.Kjo i përket të drejtës pasurore të autorit.Po ashtu botimi i veprës është i kushtëzuar me dhënjen e pajtimit të autorit për publikimin e veprës së tij që paraqet realizimin e të drejtave morale të autorit⁵⁵.

⁵⁴ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq .18-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

⁵⁵ Aliu Abdulla E Drejta e Autorit fq 37,Prishtinë 2004

Përmbajtjen e të drejtave pasurore e krijon e drejta e shfrydzimit të veprës.

Vetëm autori është i autorizuarë ta shfrydzoj veprën e tij ndërsa personat tjerë te cilet nuk janë autor,mund ta shfrytëzojnë veprën vetëm me leje të autorit.

Simbas legjistacionit shqiptar të drejtat pasurore njihen si të drejta ekonomike,me të cilatkuptohen se të drejtat ekonomike lejojnë mbajtësin e të drejtave të përfitoj shpërblime financiare nga përdorimi i veprës së tij nga të tjerët⁵⁶.Për gjdo shfrydzim të veprës nga ana e personave të tjerë,autorit i takon kompenzimi.

Krahas të drejtës për shfrydzimin e veprës,autorit ka edhe të drejtë që veprën ta vë në shitje në treg në atë formë dhe mënyrë e cila konsiderohet e përshtatshme.Disponimi mund të realizohet me punë juridike inter vivos,kontrata e autorit apo mortis causa,rrugës ligjore apo trashigimisë testamentale.

Ligji i vitit 1978 ka parapa me rregulla për të drejtën pasurore,shprehimisht parashehë vetëm të drejtën e shfrydzimit të veprës.Mirëpo edhe e drejta e disponimit dhe e vënies në qarkullim-treg të veprës së autorit,paraqet të drejtën pasurore të autorit.Të drejtat pasurore të autorit përbëjnë të drejtat e autorit në shfrydzimin e veprës.

Shfrytëzimi i veprës së autorit kryet përmes:

Publikimit

Përpunimit

Reprodukimit me publikimin

Shumëzimin

Përshtatjen me emëtimin

Kryerjen dhe bartjen

Përkthimin e veprës etj.

Veprën e autorit kur shfrytëzojnë të tjerët ata e bëjnë këtë vetëm me leje të autorit,po që se me ligj nuk është e paraparë ndryshe⁵⁷.

Autori gëzon të drejtën ekskluzive të shfrydzimit të veprës së vet në gjdo formë dhe mënyrë.Autori i një vepëre letrare,artistike ose shkencore gëzon të drejtën e shpërblimit për gjdo rast dhe për gjdo mënyrë të shfrytëzimi të veprës,të lejuarë apo jo nga vet ai,edhe nësë heq dorë nga kjo e drejtë.

⁵⁶ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq.135 –Shtëpia botuese Skangerbeg books,Tiranë 2009

⁵⁷ Aliu Abdulla E Drejta e Autorit fq 38,Prishtinë 2004

4.2 E drejta ekskluzive e shfrytëzimit të veprës:

1.Autori gëzon të drejtën ekskluzive për ta shfrytëzuarë veprën e vet në formë materiale dhe jomateriale.

2.Autori gëzon të drejtën ekskluzive,duke pasur parasysh veprën e vet,në tërësi ose pjesërisht për të autorizuarë:

a)riprodhimin e drejtëpërdrejtë ose të tërthortë,të përkohshëm ose të përhershëm me qfardo llojë mjeti apo forme:b)shpërndarjen në publik të orgjinalit ose të kopjeve të veprës në qfardo llojë forme,duke shitur,dhënë me qira,dhëne hua apo dhuruar:c)importimin,eksportimin dhe shpërndarjen e kopjeve të veprave të prodhuara me pëlqimin e tij:q)shfaqjet skenike,recitimet,gjdo llojë tjetër ekspozimi në publik ose shfaqëje të drejtëpërdrejtë të veprës:d)ekspozitat publike të veprave të arteve të bukura,arteve të aplikuara,krijimet fotografike dhe veprat arkitekture,dh)shfaqjet publike të veprave kinematografike dhe të veprave të tjera audiovizuele,e)transmetimin e një krijimi me anë të gjdo mënyre riprodhimi të sinjaleve,tingujve dhe pamjeve me ose pa fije,duke përfshirë edhe transmetimin satelitor,ë)transmetimin për publikun të një vepëre me anë të fijeve,kabllit,fibrave optike ose me gjdo mënyrë tjetër:f)përcjelljen te publiku të një vepëre me anë të regjistrimeve audio ose audiovizuele:g)ritransmetimin e plotë,të pandërprërë dhe në të njëjtën kohë të një vepre me anë të mjeteve të përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të këti neni,prej një stacioni transmetues që është i ndryshëm nga radioja ose televizioni transmetues i veprës:gj)modifikimin e veprës: h)vënien e veprave në dispozicion te publiku,nëpërmjet mjeteve me lidhje me ose pa tel,në mënyrë të tillë që publiku të mund ti përdorë nga gjdo vend dhe në qfardo kohe,të zgjedhur prej secilit⁵⁸.E drejta e shpërndarjës së veprës.E drejta e shpërndarjës së veprës orgjinale ose të kopjeve të saj shuhet,kur kjo e drejtë ushtrohet nga titullari i kësaj të drejte ose me miratimin e tij,nëpërmjet shitjes së parë ose me gjdo mënyrë tjetër për kalimin e pronësisë dhe vetëm kur këto veprime e zveshin atë nga e drejta e rishpërndarjës së veprës në vazhdimësi,si dhe nga e drejta e qiradhënies⁵⁹.

⁵⁸ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura më të neni 12-13,shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

⁵⁹ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtata e tjera të lidhura me të neni 14,shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

Në nenin 12 ,deri ne nenin 18 të ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të Rep. e Shqipërisë të ligjit listohen të gjitha të drejtat me karakter pasuror të tij. Në të drejtat pasurore ligjore te autorit përmendim:

A)Autori gezon te drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të veprës se tij ne qdo formë dhe mënyre. Autori gëzon të drejtën ekskluzive për ta shfrytëzuar veprën e tij në forme materiale dhe jomateriale.Autori gëzon te drejten ekskluzive, duke patur parasysh veprën e tij në tëresi ose pjesërishtë, per të autorizuarë: riprodhimin, shpërndarjen në publik, improtimin, qeradhënien, huapërdorjen e të tjera, te cila do t'i trajtojmë më poshtë⁶⁰.

B)E drejta për riprodhimin direkt ose indirekt,të përkohshem ose të përhershëm,me qfarë do lloj mjeti apo forme.Ajo lejon pronarin e së drejtës së autorit,të përjashtojë gjithë të tjerët nga riprodhimi i punës në formen e një kopjeje,ose të një regjistrimi phono.E drejta e riprodhimit në rastin e regjistrimeve të zërit është specifike,sepse regjistrimet phono nuk cilësohen si kopje.Pa e shtuarë këtë tek të drejtat ekskluzive,të tjerët mund të jenë të lirë për të prodhuarë regjistrime phono të veprës që ka bërë pronari.

C)E drejta tjetër e autorit është ajo për shpërndarjen në publik të një orgjinali ose kopjeje të veprës në qfardo lloj forme,duke e shitur,duke e dhënë me qera,dhënë hua dhuruar ose formë tjetër.

Shpërndarja është e drejtë ekskluzive që i garanton pronarit të së drejtës së autorit të drejtën për të shpërndarë kopje ose regjistrime phono për publikun,me anë të shitjes ose transfertë tjetër pronësis,ose duke i dhënë me qera.

Meqë të drejtat e veprës së prejardhur dhe riprodhuese i sigurojnë pronarit të së drejtës së autorit pothuajse të gjitha format e bazës së ndonje shpërndarje publike,e drejta e shpërndarjesmund të konsiderohet më shumë si një kufizim se sa një dhënie e një të drejte ekskluzive.Në këtë kuptim, prandaj është quajtur doktrina e shitjes së parë⁶¹.

Doktrina e shitjes së parë siguron pronarin e të drejtë së autorit se derisa të ndahet nga pronësia,ai gëzon të drejtën të ndaloj të tjerët ta shpërndajn veprën e tij.

D)E drejta për importimin,eksportimin dhe shpërndarjen e kopjeve të veprave,të prodhuara me pëlqimin e autorit.

Ka raste kur kjo e drejtë e autorit egziston e veqantë.

⁶⁰ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq.135-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

⁶¹ Vepra e cituar fq.154

Kështu improtimi,eksportimi dhe shpërndarja e veprës është një e drejtë që i përket autorit dhe ky ia kalon një personi tjetër duke i vënë në dispozicion tirazhin e veprës në formën e saj orgjinale.Ka raste të tjera kur importimi,eksportimi dhe shpërndarja ndërthuren me të drejtat e tjera ekskluzive.Kështu në rastin e përkthimit të veprave të autorëve të huaj, e drejta e autorit për eksportimin e veprës,lidhet ngushtë me të drejtën për të lejuar apo autorizuar krijimin e një vepre të prejardhur në formën e përkthimit dhe importimin e saj nga një përdorues në Shqipëri ,si dhe me të drejtën e shpërndarjes së versionit në shqip të veprës,në teritoret shqipfolëse.

E)E drejta për shfaqjet skenike,recitimet,gjdo lloj tjetër ekspozimi në publik ose shfaqje direkte të veprës. E drejta ekskluzive e shfaqjes në publik ose shfaqje direkte të veprës.E drejta ekskluzive e shfaqjes në publik që i takon pronarit të së drejtës së autorit për të shfaqur veprën e tij është diqka relativisht e re.Megjithatë ,nuk është një e drejtë shumë e gjerë dhe së fundi duket se mbulon vetëm pak situata.

F)E drejta për të marrë pjesë në ekspozitat publike të veprave të arteve të bukura,arteve të bukura,arteve të aplikuara,krijimet fotografike dhe veprat arkitekturore.

G)E drejta e shfaqjes publike të veprave kinomatografike dhe të veprave të tjera audiovizuele.

H)Transmetimii një krijimi me anë të gjdo mënyre riprodhimi të sinjaleve,tingujve dhe imazheve me ose pa fije,duke përfshirë edhe transmetimin satelitor.

Transmetimet televizive me dhe pa kabëll,dixhitalë dhe analoge,të shfaqjeve të ndryshme të varietesë,koncertet,programet e të tjera,janë e drejtë e pronarit të veprës kolektive.Transmetimi është një e drejtë që vjen në mënyrë të njëpasnjëshme,pasi është bërë paraqitjes e veprës në publik,me anë të shfaqjes teatrale apo muzikore.Nga ana tjetër,pasi bëhet shitja,doktrina e shitjes së parë e lejon pronarin e ri ta trajtojë objektin si të vetin .Nuk është shkelje të drejtës së autorit nga ana e bleresit,që t'ia shesë punën një tjetri edhe nëse pronari i të drejtës së autorit do ta kishte kushtëzuar shitjen me premtimin se ajo do të rishtej.Ligji i të drejtës së autorit dhe e drejta e shpërndarjes i siguron pronarit të së drejtës së autorit të drejtën të kontrollojë transferimin e parë të pronësis.Një përjashtim për doktrinen e shitjes së parë e ndalon dhënien me qera të gjdo gjëje që ka të bëjë me regjistrimin phono⁶².

⁶² Tutulani-Semini Mariana e drejta e autorit në Shqipëri fq 154-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

I)E drejta për transmetimin për publikun të një vepre me anë të fijeve,kablilit,fibrave optike ose me gjdo mënyr tjetër .

J) E drejta për përcjellje të publikut,të një vepre.Përcjellja tek publiku i veprës është një koncept i gjërë,që i referohet jo vetëm audio ose audiovizuale.

K)E drejta për modifikimin e veprës dhe përshtatjen e veprës.Autori ka të drejtën ekskluzive të autorizojë qfardo përshtatje,përpunimi dhe ndryshimi tjetër si dhe përkthimin e veprës së tij.Të drejtat e autorit ,mbi veprën e prejardhur,i përkasin autorit të ri,vetëm nëse është marrë leje nga titullari i të drejtave mbi veprën orgjinale,ndërsa shfrytëzimi i sajë mund të bëhetvetëm duke moscenuarë të drejtat e këtij të fundit.

L)Vënia e veprave në dispozicion të publikut,nëpërmjet mjeteve me lidhje me ose pa tel,në një mënyrë të tillë,që publiku të mund ti përdorë nga gjdo vend dhe në qfardo kohe të zgjedhur individualishtë prej secilit.

M)Prezentimi ose paraqitja e veprës në publik është një e drejtë tjetër ekskluzive.Për shkak të zhvillimeve të teknikës së industrisë të shekullit 20-të ,e drejta e pronarit të së drejtës së autorit ,për ti përjashtuarë të tjerët nga paraqitja e veprës së tij,është një prej të drejtave më ekskluzive të siguruara nga ligjet e të drejtës së autorit.Shumë informacione merret nga mediat masive,prandaj e drejta e paraqitjes është bërë e vlefshme për një pronar të së drejtës së autorit.E drejta për një paraqitje publike zbatohet vetëm të veprat letrare,të muzikës,dramës,koreografisë,pantomimës e të tjera audiovizuale.

N)Autori i një vepre letrare,artistike ose shkencore gëzon të drejtën e shpërblimit pë gjdo rast dhe gjdo mënyrë të shfrytëzimit të veprës,të lejuar nga vetë ai,edhe nëse heq dorë nga kjo e drejtë.O)Autori gëzon të drejtën e shpërndarjes mbi veprën orgjinale ose mbi kopjen e saj,kur kjo e drejtë ushtrohet nga titullari me miratimin e tij,nëpërmjet shitjes së parë ose me gjdo mënyr tjetër për kalimin e pronësisë,dhe vetëm kur këto veprime e zhveshin atë nag e drejta e rishpërndarjes së veprës në vazhdimësi si dhe nga e drejta e qiradhënies.

P)Autori gëzon edhe të drejtën e vazhdimësis për një kategori veprash,të tilla siq janë veprat e arteve të bukura.Kjo e drejtë e vazhdimësisë shtrihet mbi veprën e shitur,për të përfituarë nga shitësi 5% të shumës,nga gjdo rishitje e këtyre veprave,e bërë në ankante publike,në institucione tregtare ose me ndërmjetësimin e një tregëtari ose agjenditregëtar.Kjo e drejtë e njohur nuk mund të mohohet,ajo përcillet vetëm anë të trashigimisë⁶³.

⁶³ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 172-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

E drejta e shfrytëzimit të veprës është ekskluziviteti i autorit, deri në momentin që ai ia kalon me kontrata ekskluzive personave të tretë. Këto lloj kontratash kanë filluar të bëhen evidente në praktiken shqiptare, duke dëshmuar për dëshirën e subjekteve botuese, për të respektuar të drejtën e shfrytëzimit të veprës të autorëve të huaj, ku përfshihet: përkthimi i veprës, botimi, përshtatja, shpërndarja, e të tjera.

Kuptohet, si çdo dukuri e re edhe këto kontrata do të shoqërohen me fenomenin e shkeljes së tyre nga të tretët dhe kjo është arsyeja që janë bërë prezente në gjykatën shqiptare. E drejta për riprodhimin direkt ose indirekt, të përkohshëm ose të përhershëm, me çfarëdo lloji mjeti apo forme. E drejta baze me ekskluzive është ajo e riprodhimit. Ajo lejon pronarin e të drejtës së autorit, të përjashtojë gjithë të tjerët nga ri-prodhimi i punës në formën e një kopje, ose të një regjistrimi phono.

E drejta e riprodhimit në rastin e regjistrimeve të zerit është specifike, sepse regjistrimet phono nuk cilësohen si kopje.

Pa e shtuar këtë tek të drejtat ekskluzive, të tjerët mund të jenë të lirë për të prodhuarë regjistrime phono të veprës që ka bërë pronari⁶⁴. E drejta e shfrytëzimit të veprës është ekskluziviteti i autorit, deri në momentin që ai ia kalon me kontratë ekskluzive personave të tretë. Këto lloj kontratash kanë filluar të bëhen evidente në praktiken shqiptare, duke dëshmuar për dëshirën e subjekteve botuese, për të respektuar të drejtën e shfrytëzimit të veprës të autorëve të huaj ku përfshihet përkthimi, botimi, përshtatja, shpërndarja e veprës etj. Kuptohet si çdo dukuri e re edhe këto kontrata do të shoqërohen me fenomenin e shkeljes së tyre nga të tretët dhe kjo është arsyeja që janë bërë prezente në gjykatën shqiptare.

E drejta e riprodhimit lidhet shumë shpesh me fotokopjimin.

Shpesh fotokopjohen pjesë të tëra tekstesh, madje edhe krijime të plota dhe shpërndahen për mësimdhënie.

Lind pyetja:

1. A shkelen të drejtat e autorit kur vepra fotokopjohet dhe shpërndahet pa leje?

Fotokopjimi lejohet pa lejen e autorit vetëm atëherë kur bëhet për mësimdhënie, për të ripërtërirë një kopje të dëmtuar të veprës apo për qëllime arkivore dhe vetëm kur plotësohen këto kushte:

⁶⁴hppt\\www.të drejtat pasurore të autorit.com

- fotokopjimi dhe shpërndarja të bëhet pa shpërblim;
- fotokopjimi të bëhet në një numër të kufizuarë;
- vepra nuk duhet të jetë në qarkullim duke u tregëtuar kundrejtë shpërblimit nga autori, sepse në të kundërtën autorit dhe veprës i kryhet konkurrencë e pandershme, duke ngadalësuar jo vetëm ritmet e shitjes së saj, por edhe në drejtim të qmimit, që për fotokopjet është më i ulët se sa për veprat e plota.

Kushtet e mësipërme duhet të egzistojnë që të gjitha në të njëjtën kohë,sepse mungesa qoftë edhe e njerit prej tyre,e shëndrron automatikisht fotokopjimin në shkelje të së drejtës së autorit të veprës së fotokopjuarë⁶⁵.Rirpodhimi i një veprë kinematografike dhe shpërndarja e sajë është një e drejtë që i takon autorit të veprës.

Lind pyetja:

A ka të drejta modeli i fotografisë mbi riprodhimin dhe shpërndarjen e veprës?

Ligji për të drejtën e autorit fletë për të drejtat e modelit ,që ka pozuar për një pikturë,por nuk flet për të drejtat e modelit të fotografisë.

Ky ligj e lidh të drejtën për të marrë leje për shpërndarjen e veprës ,me faktin nëse modeli i pikturës është paguarë për punën e tij ose jo .

Në rast se personi që ka pozuar për portretin,në pikturë është shpërblyer për seancat që ka pozuar,atëher ai nuk ka të drejta mbi fatin e veprës.Në të kundërtën po.

Ndoshta ligjvënësi është nisur për të mbrojtur interesat e një modeli,që është jo profesionalisht pjesë e veprës,por mund të jetë në kushte të jetës dhe punës së përditshme dhe normale,kështu që bërja publike e pamjeve të tij⁶⁶,kërkon lejen e këtij të fundit.

Lidhur me vlerën e përdorimit të veprës,siq është rasti i pikturës ose i fotografisë,si rregull,duhet të përcaktohet në raport me vlerën e kopjes së saj.

Vepra është një pasuri apo një send për autorin dhe jo më kot e drejta e autorit futet brenda ati koncepti,që quhet e drejtë e pronësisë intelektuale.

Kjo do të thotë,se edhe këtu kemi një marrdhënie pronësie pronar-autor dhe pronë-vepër.

⁶⁵ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 140-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

⁶⁶ Vepra e cituar fq.144

Për rrjedhonjë,sendi ka vlerëne tij dhe përdorimi ka vlerën e tij dhe si rregull përdorimi nuk mund të jetë më i madh se vlera e vetë pronës⁶⁷,qeraja e sendit nuk mund të ketë shpërblim më të lartë se shitja e sendit.Lidhur me fotografimin e një skulpture të vendosur një vend publik,mendoj se ajo mund të fotografohet pa marrë lejen e autorit të saj,sepse me të drejtën e autorit konkurren fort interesi publik.Një vepër e vendosur në një shesh,rrugë e të tjera kalon në pronësi të të gjithë publikut ,sepse i tillë është qëllimi i vendosjes së saj.

4.3 Karakteristikat e të drejtave pasurore te autorit

Autori ka të drejtë ekskluzive për shfrytëzimin pasuror të veprës së tij në qfardo forme,si dhe t'ia lejojë apo ndaloj personave të tjerë shfrytëzimin e veprës së tij,nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.Personat e tjerë mund të shfrytëzojnë veprën e autorit vetëm në bazë të autorizimit të autorit për kalimin e të drejtave ekskluzive dhe me kushtet e vendosura prej tij,nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.Për gjdo kalim të të drejtës për shfrytëzimin e veprës,autorit i takon kompenzimi,nëse me këtë ligj ose me kontrat nuk parashihet ndryshe⁶⁸ .E drejta pasurore e autorit për nga natyra është e drejtë ekskluzive dhe absolute qe vepron erga omnes.Në këtë pikpamje,e drejta pasurore nuk dallohet nga e drejta morale e autorit dhe së bashku i takojnë të drejtës subjektive të autorit. Karakteri absolut i të drejtës së autorit konsiston në atë që mund ta ndaloj mënyren e shfrytëzimit të veprës për të cilën ai nuk ka dhënë pajtimin,pamarparasysh kush e kryen shfrytëzimin.Pasi që detyë e të drejtave pasurore është mbrojtja e interesave material-juridike të autorit kjo është kuptueshëm që të drejtat pasurore janë të drejta të bartshme.Autori ka të drejtë t'i bartë të drejtat pasurore në personin e tretë,dhe atë me kompenzim apo pa kompenzim.

Bartja e të drejtave pasurore paraqet një nga dallimet themelore në mes te drejtave morale dhe pasurore që rrjedhin si domosdoshmëri nga karakteri i të drejtës pasurore që rregullon qështjet në lidhje me shfrytëzimin dhe disponimin e veprës.

⁶⁷ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 150-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

⁶⁸ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 21,Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

Autori i gëzon të drejtat pasurore në veprën e tij gjatë gjithë jetës së tij,përfshirë bënë disa lloje të veprave fotografike,veprat e artit aplikativ,programet llogaritëse,ku zgjatja e mbrojtjes juridike është e kufizuarë në numer të caktuar të viteve,panvarsisht nga kohëzgjatja e jetës së autorit.

Pasi që bashkësia shoqërore është e interesuarë që vepra e autorit të bëhet sa më parë e mirë e përgjithshme,kufizohet kohëzgjatja e të drejtës pasurore të autorit,gjegjësisht e drejta e trashigimtarëve të autorit ta shfrytëzojnë veprën e autorit si bartës absolut dhe ekskluziv i të drejtës së autorit .Afati i përgjithshëm i kohëzgjatjës së drejtës së autorit është gjatë gjithë jetës së tij dhe 70 vite pas vdekjes⁶⁹.

4.4 E drejta në shfrydëzimin e veprës

Përmbajtjen e të drejtave pasurore të autorit e krijojnë drejta e autorit në shfrytëzimin e veprës.Edrejta në shfrytëzimin e veprës është e natyrës ekskluzive,absolute,në kohën e kufizuar,dhe e bartëshme.

Ligji numëron format e shfrytëzimit të veprës së autorit.

Një nga mënyrat e shfrydëzimit të veprës së autorit është përpunimi dhe përshtatja.

Për dhënien e pajtimit për përshtatje të veprës dhe rregullimit të raporteve bëhet më së shpeshti me kontrat në mes të autorit të veprës origjinale-burimore dhe autorit të veprës së përshtatur apo personit juridik i cili paraqitet si shfrytëzues i veprës së autori.

Veprat kinematografike të krijuara në përpunim apo veprat që kanë burim ndonjë vepër letrare e muzikore,shkencore dhe artistike,është e mbrojtur si vepër burimore,gjegjësisht autorët veprave kinematografike kanë të gjitha të drejtat morale dhe pasurore në veprat e tyre,me kusht të respektimit të të drejtave të autorit të veprës burimore⁷⁰.

Përfshirëmet nga e drejta e qeradhënies dhe e huadhënies

1.Përfshihen nga e drejta e qeradhënies vënia në dispozicion e veprës,me qëllim ekspozimi,reklamimi ose përcjellje në public nëpërmjet fonogrameve ose regjistrimeve audiovizuale(videograme),përfshi këtu edhe pjesë të secilës prej tyre,si dhe vënia në dispozicion për konsultim në vend.

⁶⁹ Aliu Abdulla E drejta e autorit fq 38,Prishtinë 2004

⁷⁰ Vepra e cituar fq.40

2.Përfshihen nga e drejta e huadhënies vënia në dispozicion e veprës,me qëllim ekspozimi,reklamimi ose përcjellje në publik nëpërmjet fonogrameve ose regjistrimeve audiovizuale,(videograme)përfshi këtu edhe pjesë të secilës prej tyre si dhe vënia në dispozicion për konsultim në vend.

3.Konsiderohet se nuk ka përfitim ekonomik ose tregtar të drejtpërdrejtë,kur huazimi bëhet kundrejt shpërblimit në një vlerë,e cila nuk është me e madhe se ajo që shërbeu për të mbuluarë shpenzimet e veprimtarive për dhënien hua të veprës⁷¹.

4.Pavarsisht nëse e drejta e qeradhënies apo e huadhënies së veprës i njihet prodhuesit të fonogramit,prodhuesit të veprave kinematografike,autovizuele ose te sekuencave me pamje të lëvizshme,autori dhe ose interpretuesi gëzon të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm për kontratën e qiradhëniës apo të huadhëniës,të nënshkruarë nga prodhuesi me të tretët.Kjo e drejtë mund të ushtrohet edhe nëpërmjet të tretëve të autorizuarë,të cilët përfaqsojnë autoret dhe ose interpretuesit.

5.Parashikimet e këtij neni për qeradhënien ose huadhënien nuk jnaë të zbatueshme për vepra arkitekturore dhe veprat e arteve të aplikuara.Të vepra e autorit ku mënyra e shprehjes është gjuha krahas publikmit të veprës,mënyrë e shpeshtë e shfrydzimit të veprës është edhe përkthimi i saj.

Autori ka të drejtën ekskluzive që ta jap lejen për përkthimin e veprës.Autori i përkthimit gëzon të gjitha të drejtat morale dhe pasurore në veprën e tij në respektimin e të drejtës morale dhe pasurore të autorit të veprës burimore.

Një mënyrë e shfrydzimit të veprave gojore-letrare,shkencore dhe të dramës është edhe recitimi dhe leximi i tyre publik.Autori i veprave gojore ka të drejtën ekskluzive ta jap lejen për recitim dhe lexim publik.

Të veprat e dramës,dramë-muzik dhe vepra muzikore,mënyrë themelore e të shprehurit të veprës është paraqitja e tyre publike dhe interpretimi publik.Autorët janë të autorizuarë të japin leje për paraqitje publike.Pa pajtimin e tyre është e ndaluarë.

Një nga mënyrat e shfrytëzimit të veprës së autorit është incizimi në pllaka gramafoni,videokasetat dhe në mjetet për riprodhim të zërit dhe të fotografisë.

⁷¹ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 15 Rep.e Shqipërisë shpallur në dekretin nr.4587 Tiranë 2005

Për të gjitha veprat që incizohen në këtë mënyrë duhet që autori të japë leje.

Në pikpamje të shfrytëzimit të veprës së përbashkët nga ana e autorëve zbatohen rregullat e të drejtës së përgjithshme. Kjo do të thotë që të gjithë autorët kanë të drejta të njëjta në veprë ashtu që vendimet për shfrytëzim i bien bashkërisht dhe njezëri nëse me kontrat në mes tyre nuk është parapa diqka tjetër. Për gjdo shfrytëzim të veprës së autorit nga personat tjerë, autorit i takon shpërblimi nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe⁷². Shfrytëzimi pa autorizim cenon të drejtat e autorit burimor.

4.5 Të drejtat tjera pasurore

Krahas të drejtës së shfrytëzimit të veprës të cilën e parashohin Konventa e Bernës⁷³, dhe ligjet e vendeve të caktuara, duke përfshirë këtu edhe vendin tonë. Kuptohet e drejta e autorit të veprës orgjinale mundet gjatë kohëzgjatjes së mbrojtjes së të drejtës së autorit të kërkoj një pjesë të mjeteve të fituara të cilat i ka fituarë personi i parë i veprës së tij me shitje të mëtejshme të veprës personave të tjerë.

Ky institute ka për detyrë ta mbroj autorin nga eksploatimi në rastet kur nga informimi i pamjaftueshëm apo vështërsit material ka qenë i obliguarë ta bart –tjetërsoj veprën e tij më ulët se sa që është vlera reale artistike dhe në këtë mënyrë ka ardhur deri të pasurimi i pabazë i personave të tjerë që kanë keqpërdorur poziten e autorit në momentin e tjetërsimit të veprës.

Autori ka të drejtë ekskluzive të autorizojë gjdo përshtatje, përpunim dhe ndryshim si dhe përkthim që mund ti bëhet veprës së tij.

Të drejtat e autorit mbi veprën e prejardhur i përkasin autorit të ri, vetëm nëse është marrë autorizim nga autori apo titullari i të drejtave mbi veprën orgjinale, ndërsa shfrytëzimi i saj mund të bëhet vetëm duke mos cenuar të drejtat e tyre mbi veprën orgjinale⁷⁴. E drejta e vazhdimësisë: 1. Autorët e veprave të arteve të bukura kanë të drejtën e vazhdimësisë mbi veprën e shitur, për të përfiturë nga shitësi jo më pak se 5 përqind të shumës nga gjdo rishitje e veprës por në asnjë rast jo më pak se 5000 lekë.

E drejta e njohur në pikën 1 të këtij neni mund të kalohet vetëm me anë të trashëgëmisë.

⁷² Aliu Abdulla E drejta e autorit fq 30, Prishtinë 2004

⁷³ Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike 1886

⁷⁴ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 17, shpallur në dekretin nr. 4587 Tiranë 2005

Rishitësit detyrohen të njoftojnë organizatën administruese të veprës përkatëse ose sipas rastit, autorin a personat, që gëzojnë të drejtat e autorit mbi veprën brenda 30 ditëve, duke filluar nga data e rishitjes, dhe të depozitoj dokumentacionin e nevojshëm, në mënyrë që të paguhet shpërblimi i të drejtës së vazhdimësisë.

Po ashtu kur ata veprojnë për llogari ose si përfaqësues të shitësit paraardhës, ata janë bashkërisht përgjegjës për shpërblimin e së drejtës dhe për këtë arsye detyrohen të llogarisin në qmimin e rishtijës pjesën përkatëse të shpërblimit të autorit.⁴ E drejta për të kërkuar të dhëna për të drejtën e vazhdimësisë mbi veprën parashkruhet brenda 3 vjetëve, duke filluar nga dita e njoftimit të shitjes, por jo më vonë se 5 vjet që nga data e shitjes, nëse nuk është kryer njoftimi⁷⁵. Konventa e Bernës parasheh të drejtën e autorit si të drejtë të patjetërsueshme të autorit që të interesohet për shitjen e orgjinalit të veprës së tij autentike apo dorëshkrimit orgjinal të shkrimtarit apo kompozitorit.

E drejta e autorit paraqet një autorizim të ri pasuror të cilën e parashohin një numër i vogël i ligjeve nacionale (Gjermania, Franca, Belgjika, Italia, Çekia, Sllovakia) të cilat i takojnë sistemit kontinental të së drejtës. Pas vdekjes së autorit e drejta e autorit kalon të trashigimtarët ligjor dhe testamentarë. E drejta e trashëgimit nuk mund të jetë objekt i realizimit me dhunë. Duke e pranuar të drejtën e autorit për ato lloje të veprës të cilat i parasheh Konventa e Bernës dhe një numër i madh i rregullave bashkëkohore nga fusha e të drejtës së autorit, ligji parasheh nga kjo e drejtë veprat e arkitekturës dhe veprat e artit grafik. Ligji gjerman mbi të drejtën e autorit përmban rregulla me përmbajtje të njejtë me kërkesë të autorit për ndërrim të kontratës dhe atë për dy vite nga moment kur autori është i njoftuar me rrethanat (afati subjektiv) dhe dhjetë vite (afati objektiv). Pra mundësohet që autori i dëmtuar të ketë të drejtë në ndryshimin e kontratës me të cilën ka bartur shfrytëzimin e veprës së autorit⁷⁶.

Autori ka të drejtë të qaset orgjinalit apo eksemplarit të veprës së tij që është në zotrim të personit tjetër, kur kjo i nevojitet për ta riprodhuarë apo përpunuarë veprën, nëse nuk preken thelbësisht interes e arsyeshme të zotruesit.

Autori ka të drejtë të kërkojë nga zotruesi i orgjinalit të veprës së tij figurative ose fotografike që ti'a dorëzojë atë përkohësisht me qëllim të ekspozimit.

⁷⁵ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 18, shpallur në dekretin nr. 4587 Tiranë 2005

⁷⁶ Aliu Abdulla e drejta e autorit fq 40-41, Prishtinë 2004

Dhënien përkohësisht të orgjinalit zotëruesi mund ta kushtëzojë me dhënien e garancionit monetar të mjaftueshëm ose me lidhje të kontratës për sigurim në lartësi të vlerës në treg të orgjinalit.

Autori është i detyruar të kujdeset që mënyra e qasjes së veprës ose ekspozimi i saj të rezultojë në sa më pak shqetësime për zotëruesin. Në rast se dëmtohet orgjinali ose ekzemplari i veprës, autori mbanë përgjegjësi objektive edhe pa qenë i fajshëm për dëmtim⁷⁷.

4.6 Kufizimi i të drejtave pasurore në Kosovë

Rregullat ligjore nga fusha e të drejtës së autorit u njohin autorëve të drejtat absolute për shfrytëzimin e veprës së tyre, mirpo ato parashohin edhe një numër të caktuar të rasteve kur të drejtat e autorëve në shfrytëzimin e veprës kufizohen.

Konventa e Bernës u lejon vendeve nënshkruese që me rregullat e tyre nacionale të kufizojnë disa të drejta pasurore të autorit⁷⁸.

Kufizimet mund të ndajmë në kufizime në dobi të interesave personale të shfrytëzuesit përdorimi privat dhe shumëzimi i veprës për qëllime private, për nevojat e hulumtimeve shkencore etj., kufizimet në dobi të shkencës dhe të artit, kufizimet që paraqesin citate të autorëve nga autorë të tjerë, kufizimet në interes të përgjithshëm dhe kufizime në dobi të institucioneve të caktuara. Në ligjet e të drejtës së autorit të vendeve të ndryshme paraqiten disa kufizime të llojit të veçantë të cilat janë karakteristike për sistemin juridik të atyre vendeve p.sh Gjermania, Britania e Madhe etj.

E drejta jonë parasheh gjashtë lloje të kufizimit:

E para, nëse është fjala për vepër shkencore, shfrytëzimi i së cilës është i rëndësishëm së veçantë për siguri shtetërore andaj shteti mundet që me kompenzim të caktuar ta kufizojë të drejtën e autorit. Shfrytëzimi i veprës shkencore mund të bëhet edhe pa pëlqimin e autorit me pagimin e kompenzimit për shfrytëzim.

Grupi i dytë i kufizimeve i përfshinë rastet në të cilat ligjdhënësi parasheh që vepra e autorit mund të shfrytëzohet pa kërkim të lejës por me pagim të kompenzimit për shfrytëzim, kjo qëndron në pesë raste:

⁷⁷ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 35, Ligjin nr 04/L-065, 30 Prishtinë 2012

⁷⁸ Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike 1886

-rasti i parë ka të bëjë me shfrytëzimin e veprës letrare, shkencore, shkencore apo artistike për qëllim të ligjërimit.

-rasti i dytë ka të bëjë me rishtypjen dhe publikimet e kohëpaskohëshme të disa artikujve aktual me të cilët shtjellohen pyetje të përgjithshme të interes publik, me kusht që autori i atyre artikujve decidivisht nuk e ka ndaluar rishtypjen e tyre.

-reprodukimi i gazetave dhe publikimeve të kohëpaskohëshme të fotografive aktuale, ilustrimet⁷⁹, të cilat kanë qenë të publikuara në gazeta të tjera apo publikime.

-rasti i katërt ka të bëjë me reproduktimin e fotografive artistike të ekspozuara në rrugë në sheshe etj.

-rasti i pestë ka të bëjë me reproduktimin e figurave artistike dhe veprave të arkitekturës, në fotografi, në gazeta përshtimë bënë nëse autori decidivisht e ka ndaluar. Të gjitha këto kufizime të cilat i ka parapar ligjdhënësi janë bërë në interes publik, në interes të ligjërimit dhe edukimit me qëllim të informimit të publikut për ngjarjet aktuale.

Grupi i tretë i kufizimeve përfshinë rastet në të cilat vepëra e autorit shfrytëzohet pa lëshimin e autorizimit por edhe pa obligim të kompenzimit të autorit për shfrytëzimin e veprës së tij. Edhe në këto raste autori ruan të gjitha obligimet morale. Me paraqitjen dhe prezentimin e veprave letrare dhe artistike për qëllim të ligjërimit, publikimi i raporteve për veprat e publikuara letrare, artistike dhe shkencore, në të cilat përmbajtja e veprave riprodhohet në mënyrë origjinale dhe të shkurtër, me ekspozimin e veprave në ekspozita publike, me kusht që autori në mënyrë decidive nuk e ka ndaluar, që ka të bëjë me reproduktimin e veprës së pikturës apo reproduktimin e veprës së arkitekture, me citimin e ndonjë pjese të publikuar artistike apo shkencore, nëse citati nuk përfshin më shumë se një të katërten. *Grupi i katërt* ka të bëjë me shfrytëzimin e lirë të disa llojeve të caktuara të veprave gojore fjalimet në gjyqe dhe organe shtetërore, si dhe në organizata të tjera shkencore, artistike, në mbledhje politike, fjalime zyrtare, në mjetet e informimit publik përmes radio-difuzionit. *Grupi i pestë*, në shfrytëzimin e lirë të veprave letrare, popullore dhe vepra artistike me kusht që shfrytëzuesi të shenoj prejardhjen e veprës dhe ta respektoj pacenueshmërinë. *Grupi i gjashtë*, një lloj i veçant i kufizimit që ka të bëjë me të ashtëquajturën licencat ligjore. Në rast të licencave ligjore të drejtat e shfrytëzimit të veprës së autorit i fiton institucioni i caktuar në baze të rregullave ligjore.

⁷⁹ Aliu Abdulla Edrejta e autorit fq 41, Prishtinë 2004

Fjala është për një lloj të caktuarë të veprave të autorit.

Fjala është për veprat e përshtatshme që të ingjizohet në instrumente për reprodukim mekanik dhe të emitohen përmes radio-difuzionit⁸⁰.Licenca ligjore së pari është aplikuarë në Angli me qëllim të pengimit të monopolizimit të prodhimit të mjeteve për reprodukimin mekanik të zërit dhe të fotografisë.Në disa vende(Gjermani)⁸¹,takohemi me licencë të dhunshme,autori apo titullai i të drejtës së autorit me kushte të caktuara t'ia lejojë kërkuesit të drejtën e shfrytëzimit të veprës së autorit.

4.7 Kufizimet e të drejtës së autorit në Shqipëri

Kur flasim për disa kufizime të së drejtës së autorit,do të kemi parasyshë rastin kur vepra ose pjesë të saj mund të përdoren nga subjektet e interesuara,pa marrë lejen paraprake të autorit.Këto raste kufizimesh janë taksative.Në raste të tjera duhet të bëhet shumë kujdes që përdorimi i veprës të jetë në mënyr të drejtë. Në disa raste përdorimi i drejtë rregullohet me titull nga autori,në raste të tjera qai quhet i drejtë dhe nuk ka nevojë për një autorizim të posaqshëm.Lejohen,pa miratimin e autorit edhe pa asnjë shpërblim,përdorimet e një vepre,me kusht që të mos cenojnë të drejtën e autorit ose të titullarit,të së drejtës së autorit mbi veprën në rastet kur:

a)riprodhimi i shkrimeve të veqanta,pjesëve të shkëputura të veprës,në botimet ditore,periodike ose në transmetimet e radios dhe të televizionit nëse përmendet emri i autorit dhe burimi i riprodhimit,si dhe kur nuk është parashikuarë,shprehimisht ndryshe⁸².Lejohet përdorimi i lirë i një vepre me qëllim dhënien informacioni,duke treguarë burimin dhe emrin e autorit kur:

-riprodhimi i shkrimevet të veqanta,të pjesëve të shkëputura të veprës,në botimet ditore,periodike ose në transmetimet e radios dhe të televizionit,nëse përmendet emri i autorit dhe burimi i ripirodhimit,si dhe kur nuk është parashkruar ndryshe.

-riprodhohet një artikull i botuar në një revistë apo gazetë,me tamë pasurore,politike ose fetare,i cili shpërndahet me anë të shtypit,transmetimit për publikun me kabëll në rastet kur e drejta e riprodhimit apo e transmetimit për publikun nuk është shprehimisht e kufizuarë.

⁸⁰ Aliu Abdulla E drejta e autorit fq 43,Prishtinë 2004

⁸¹ Vepra e cituar fq.44

⁸² Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 178-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

-riprodhohet dhe i jepet publikut,në rastet kur jepen lajme për një ngjarje të ditës,një vepër e parë ose e dëgjuar gjatë asaj ngjarje,me anë të fotografisë,kinematografisë,transmetimit me kabëll pa kaluar masën e qëllimit informativ,

-riprodhimi pjesor i veprës për qëllime studimi bëhen kur plotësohen disa kushte:

1.shkurtimi,citimi ose riprodhimi i fragmenteve,ose pjesëve të një vepre,për qëllime kritikizmi ose diskutimi,ose për qëllime pergaditje teorike,lejohen brenda kufijëve të këtyre qëllimeve,me kusht që këto veprime të mos cenojnë shfrytëzimin tregëtare të veprës.

2.shkurtimi,citimi ose riprodhimi duhet të shoqërohet gjithmonë me përmendjen e titullit të veprës dhe të emrit të autorit,botuesit dhe në rastin e një përkthimi përkthyesin,sa herë që këto përmendje janë vënë dhe në veprën që është riprodhuarë.

3.citimi të jetë i ndershëm dhe i saktë

4.nga citimi nuk duhet të tejkalohet qëllimi i përdorimit

5.në analogjitë për përdorim shkollor,riprodhimi nuk duhet të kalojë masën e përcaktuar sipas dispozitave të posaqme në fuqi,që gjithashtu vendosin dhe mënyrën për përcaktimin e shpërblimit për këtë riprodhim⁸³.

-riprodhimi i fjalimeve të mbajtura në tubime publike,në botimet ditore ose periodike të ndryshme,si dhe transmetimi i tyre për publikun,në radi ose televizion,duke cituar së bashku me emrin e autorit,datën dhe vendin ku është mbajtur fjalimi.

-riprodhimi i një vepre ose i një vepre të saj,gjatë një procedure gjyqsore ose administrative,në masen e justifikuarë nga qëllimi i përdorimit duke treguarë burimin e veprës dhe autorin e saj.

-riprodhimi i veprave ose pjesëve të veprave për përdorim vetijak të lexuesit ose të gjdo përdoruesi tjetër,me kusht që këto veprime të mos të cënojnë shfrytëzimin tregëtar të vepres.

-riprodhimi i një vepre të fiksuarë në një mbajtës zëri ose figure,ose në një mbajtës grafik,nga një person fizik,për qëllime të përdorimit vetijak ose familjar,si dhe pa kryer asnjë veprim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë tregtarë me kusht që titullarët e të drejtave mbi veprën e riprodhuarë të shpërblehen në një masë kompensuese.

⁸³ Tutulani-Semini Marian E drejta e autorit në Shqipëri fq 179-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

-fotokopjimi i veprave që ndodhen nëpër biblioteka publike,i cili bëhet për përdorim vetiak,brenda këtij mjedisi,ose për shërbime të bibliotekës.Në huadhënien e veprave nga bibliotekat ose nga shtëpitë diskografike,që i përkasin shtetit ose autoriteteve publike,të prodhuara ekskluzivisht për qëllime të reklamës kulturore,apo për përdorim vetiak,nuk kërkohet autorizim nga titullari i të drejtave,ndaj të cilit nuk detyrohet ndonjë shpërblim⁸⁴.

-Ligjvënësi parashikon se ka raste kur lejohet riprodhimi i veprës për reklam kulturore.

-lejohet riprodhimi i tërë ose pjesor i veprës ,pa autorizimin e autorit ose të titullarve të së drejtës,me rastin e huadhënies së këtyre veprave nga institucionet publike,që disponojnë kopje orgjinale të ligjshme të veprës.

-riprodhimi i veprave ose pjesëve muzikore,pa qëllim fitimi.Grupet muzikore dhe bandet e forcave të armatosura të shtetit mund të interpretojnë copëza muzikore në publik,pa kryer ndonjë pages në lidhje me të drejtat e shfrytëzimit të veprës,tek titullari i tyre ,me kusht që shfaqja të mos jetë realizuarë për qëllime përfitimi.

-lejohet përdorimi i një vepre për ilustrime,në botime,transmetime apo regjistrime të zërit të figurës,për mësimdhënie dhe riprodhimi i artikujve të vequarë në një revistë apo gazetëi pjesëve të shkruara të shkëputura nga një veper e botuar,sipas ligjit për mësimdhënie apo provime në institucionet shkollore.

-lejohet riprodhimi,transmetimi ose komunikimi për publikun me kabëlli një fotografie të një vepre arkitekture,artit të bukur,vepre fotografike ose vepër e artit të aplikuarë,të vendosur në një vend publik,shesh,rrugë, park e të tjera me përjashtim të rasteve kur fotografia është tema kryesore e riprodhimit dhe kur përdoren për qëllime të fitimi tregtar.

-lejohet që pronari ligjor i një programi kompjuteri të bëjë një kopje apo një përshtatje të një programi të tillë që:

a)këto kopje të jenë të deomosdoshme për përdorimin e programit të kompjuterit,për qëllimin për të cilin është marrë programi,në rrugë ligjore.

b)që të përdoren për arkiva dhe po të jetë nevoja në rastin kur kopjet humbisin ose dalin jashtë përdorimit,të zëvendësohet kopja e marrë në rrugen ligjore.

⁸⁴ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 181 –shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009

-pëlqimi i autorit nuk është i detyrueshëm kur riprodhimi i kodit dhe përshtatja është e deomosdoshme për marjen e të dhënave të nevojshme,nga zbërthimi i lirë i programeve të kompjuterëve, kur veprimi kryhet me anë të licencës nga një person i autorizuar që të përdor kopjen e programit.

-lejohej regjistrimi i lirë me qëllim përdorin e përkohshëm nga ana e një organi transmetues.Organi i mësipërm është i detyruar të shkatërroj regjistrimin në fjalë,brenda gjashtë muajve që nga koha e marrjes,përveq raste kur është rënë dakord me autorin e veprës,për një afat më të gjatë⁸⁵.Megjithatë një regjistrim i tillë mund të ruhet në arkiva zyrtare edhe pa egzistencen e një marëveshje të tillë,ku regjistrimi ka vlera të veqanta dokumentare apo historike.

-lejohej shfaqja publike e një vepre,gjatë një veprimtarie të një institucioni shkollorë,përgaditur nga vetë personeli,në qoftë se spektatorët janë thjeshtë personeli dhe studentët e institucionit,prindërit,kujdestarët apo personat e tjerë që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë institucion⁸⁶.

4.8 Shfrytëzimi i veprës në formë të ndryshuarë

1.Shfrytëzimi i veprës në formë të ndryshuarë përfshinë:

1.1 Të drejtën e përpunimit

1.1.1 E drejta e përpunimit është e drejtë e autorit të lejoj apo të ndaloj përkthimin,përshtatjen skenike,përshtatjen muzikore apo përpunimin e veprës së tij në mënyrë tjetër,me qëllim të krijimit të një vepëre të prejardhurë:

1.1.2 E drejta e parashikuarë në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet edhe në rastet kur vepëra e autorit,në formë të pandryshuarë,përfshihet apo ngërthehet në një vepër të re.

1.1.3 Autori i veprës burimore mban të drejtën ekskluzive për shfrytëzimin e veprës së tij në versionin e përpunuar,nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj ose me kontratë.

1.2 Të drejtën e përshtatjës audiovizuale.

2.E drejta e përshtatjës audiovizuale është e drejta ekskluzive e autorit ta lejojë apo ta ndaloj që vepëra e tij të përshtatet apo të shfrytëzohet për tu fikësuarë në veprën audiovizuale⁸⁷.

⁸⁵Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq. 185-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë

⁸⁶ Vepra e cituar fq.186

⁸⁷ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni ,Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

• 5.TË DREJTAT PASUORE SIPAS LEGJISTLACIONIT TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË

Të drejtat pasurore janë të drejta të veqanta të së drejtës së autorit.Ato bëjnë pjesë në grupin e të drejtave të bartëshme dhe në kohë të kufizuara.

Autori,duke shfrytëzuar të drejtën e tij pasurore,siguron respektimin e interesave materiale juridike dhe personale juridike,ngaqë ato janë të pandashme,të lidhura dhe në tërësi përbëjnë të drejtën subjektive të autorit. Një nga shembujt kur më së shpeshti vie në shprehje lidhmëria e të drejtës morale dhe pasurore të autorit është tek publikimi i veprës. Botimi,publikimi është një nga mënyrat e shfrytëzimit ekonomik të veprës së autorit.Kjo i përket të drejtës pasurore të autorit.Po ashtu botimi i veprës është i kushtëzuar me dhënjen e pajtimit të autorit për publikimin e veprës së tij që paraqet realizimin e të drejtave morale të autorit⁸⁸.Simbas legjislacionit shqiptar të drejtat pasurore njihen si të drejta ekonomike,me të cilatkuptohen se të drejtat ekonomike lejojnë mbajtësin e të drejtave të përfitoj shpërblime financiare nga përdorimi i veprës së tij nga të tjerët⁸⁹.Për gjdo shfrydzim të veprës nga ana e personave të tjerë,autorit i takon kompenzimi.

Dallimi midis të drejtave pasurore nga të drejtat vetiake jopasurore

Trajtimi i të drejtave pasurore do të jepet nëpërmjet dallimeve të tyre,nga të drejtat vetiake jopasuroretë autorit.Ndonëse ato janë të lidhura ngushtë me autorin dhe me veprën,për shkak të natyrës së tyre të ndryshme,për shkak të natyrës së tyre të ndryshme,për shkak të kohëzgjatjes së mbrojtjes së tyre,e të tjera,kanë karakteristika që i bëjnë të dallojnë nga njera tjetra si më poshtë:

1.Të drejtat vetiake jopasurore janë të drejta që i përkasin sferës jopasurore të interesave të autorit,ndërsa ato pasurore janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me nxjerrjen e të ardhurave nga pasja,përdorimi apo gëzimi i së drejtës së autorit.

2.Të drejta vetiake jopasurore e shoqërojnë autorin jo vetëm gjatë gjithë jetës së tij,por edhe pas vdekjes.

⁸⁸ Aliu Abdulla E Drejta e Autorit fq 37,Prishtinë 2004

⁸⁹ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq.135 –Shtëpia botuese Skangerbeg books,Tiranë 2009

Pra të drejtat vetiake jopasurore gëzohen përjetësisht,ndërsa të drejtat pasurore gëzohen gjatë gjithë jetës së autorit,si dhe pas vdekjes së tij dërsa plotësohen afatet e caktuara ligjore,që sa do të gjatë të jenë,nuk bëjë dot që këto të drejta të shoqërojnë autorinë në mënyrë të përhershme.

3.Të drejtat vetijake jopasurore kanë natyrë personale dhe kryesisht nuk kanë natyrë të transferueshme.Ndërsa të drejtat pasurore janë të lidhura me veprën dhe jo pazgjidhshmërishtë me autorin dhe ato mund të transferohen në rrugë trashigimie,ose me kontratë tek persona të tjerë⁹⁰.

5.1 Dallimet-ngjashmërit e të drejtave pasurore të autorit në Kosovë dhe në Shqipëri

Llojet e të drejtës së autorit:

Të drejtat morale

Të drejtat pasurore

Ligji i Republikës së Kosovës njeh këtë lloj ndarje,si dhe Libri bazë mbi të drejtat e autorit nga Prof. Dr .Abdulla Aliu .

Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të lidhura me të të Republikës së Shqipërisë parasheh ndarjen e të drejtave të autorit :

1.Të drejtat vetijakë jopasurore

2.Të drejtat pasurore

Të drejtat pasurore janë të drejta të veqanta të së drejtës së autorit.Ato bëjnë pjesë në grupin e të drejtave të bartshme dhe në kohë të kufizuara.Autori duke shfrytëzuar të drejtën e tij pasurore,siguron respektimin e interesave materiale,juridike dhe personale juridike,ngaqë ato janë të pandashme,të lidhura dhe në tërësi përbëjnë të drejtën subjektive të autorit.Një nga shembujt kur më së shumti vie në shprehje lidhmëria e të drejtës morale dhe pasurore është tek publikimi i veprës. Botimi,publikimi është një nga mënyrat e shfrytëzimit ekonomik të veprës së autorit.Kjo i përket të drejtës pasurore të autorit.Po ashtu botimi i veprës është i kushtëzuar me dhënien e pajtimit të autorit për publikimin e veprës së tij që paraqet realizimin e të drejtave morale të autorit.

⁹⁰ Tutulani-Semini Marian E drejta e autorit në Shqipëri fq 173-shtëpia botuese Skanderbeg,Tiranë 2009

Përmbajtjen e të drejtave pasurore e krijojnë drejta e shfrytëzimit të veprës, vetëm autori është i autorizuar ta shfrytëzojë veprën e tij, ndërsa personat e tjerë që nuk janë autor mund ta shfrytëzojnë veprën vetëm me lejen e autorit. Për gjdo shfrytëzim të veprës nga ana e personave të tjerë autorit i takon kompensim. Krahas të drejtës për shfrytëzimin e veprës, autori ka edhe të drejtë që veprën ta vë në shitje-treg në atë formë dhe mënyrë e cila konsiderohet e përshtatshme. Disponimi mund të realizohet me punë juridike inter vivos, kontratat e autorit, apo mortis kausa, rrugës ligjore apo trashëgimisë testamentale.

Të drejtat pasurore të autorit përbëjnë të drejtat e autorit në shfrytëzimin e veprës. Shfrytëzimi i veprës së autorit kryhet përmes: publikimit, përpunimit, reprodukimit me përpunimin, reprodukimin, bartjen, shumëzimin, përshtatjen me emëtimin, kryrjen, përkthimin e veprës etj. Veprën e autorit kur e shfrytëzojnë të tjerët ata e bëjnë këtë vetëm me lejen e autorit, po që se me ligj nuk është paraparë ndryshe. Autori ka të drejtën ekskluzive për riprodhimin e veprës, importimin e veprës, përgaditje, përshtatjen, shfaqjen, reklamimin e veprës para publikut, komunikimin e veprës në publik me anë të transmetimit ose ritransmetimit. Të drejtat ekonomike të autorit janë të drejta pasurore, këto të drejta janë të kufizuara në kohë deri në 70 vite pas vdekjes së autorit, cënimi i të drejtave ekonomike dhe morale nuk sjellë për pasojë vetëm përgjegjësin civile dhe financiare⁹¹, por edhe përgjegjësin penale, në të drejtën e autorit vepronjë dhe nenet 147 për mashtrimin për veprat e artit dhe të kulturës, 149 riprodhim pa të drejtë i veprës.

Në nënin 12 deri në nënin 18 të ligjit për të drejtat e autorit listohen të gjitha të drejtat me karakter pasuror të tij:

1. Autori gëzon të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të veprës së vet në gjdo formë dhe mënyrë. 2. Autori i një veprë letrare, artistike ose shkencore gëzon të drejtën e shpërblimit për gjdo rast dhe për gjdo mënyrë shfrytëzimit të veprës, të lejuar apo jo nga vetë ai, edhe nëse heq dorë nga kjo e drejtë⁹².

1. Autori gëzon të drejtën ekskluzive për të shfrytëzuar veprën e vet në formë materiale dhe jo materiale.

2. Autori gëzon të drejtën ekskluzive, duke pasur parasysh veprën e vet, në tërsi ose pjesërisht, për të autorizuar.

⁹¹ http://www.Edrejta_e_autorit/esi_hasko.com

⁹² Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 12, shpallur në dekreten nr. 4587 Tiranë 2005

- a)riprodhimin e drejtpërdrejt ose të tërthort,të përkohshëm ose të përhershëm me qfardo lloji apo forme.
- b)shpërndarjen në publik të orgjinalit ose të kopjeve të veprës në qfardo llojë forme,duke shitur,dhënë me qera,dhënë hua apo dhuruar.
- c)importimin,eksportimin dhe shpërndarjene kopjeve të veprave të prodhuara me pëlqimin etij.
- q)shfaqjet skenike,recitimet gjdo lloj tjetër ekspozimi në publik ose shfaqje të drejtpërdrejt të veprës.
- d)ekspozitat publike të veprave të arteve të bukura,arteve të aplikuara,krijimet fotografike dhe veprat arkitekturore.
- dh) shfaqjet publike të veprave kinematografike dhe të veprave audiovizuele.
- e)transmetimin e një krijimi me anë të gjdo mënyre riprodhimin e sinjaleve,tingujve dhe pamjeve,me ose pa fije,duke përfshirë edhe transmetimin satelitor.
- ë) transmetimin për publikun të një vepëre me anë të fijeve,kablilit,fibrave optike ose me gjdo mënyr tjetër.
- f)përcjelljen të publiku të një vepëre me anë të regjistrimeve audio ose audiovizuele.
- g) ritransmetimin e plotë,të pandërprerë dhe në të njëjtën kohë të një vepëre me anë të mjeteve të përcaktuara në shkronjat e dhe ë të këtij neni,prej një stacioni transmetues që është i ndryshuar nga radio ose televizioni transmetues i veprës.
- gj) modifikimin e veprës.
- h)vënien e veprës në dispozicion të publikut,nëpërmjet mjeteve me lidhje ose pa tel,në mënyrë të tillë që publiku të mund ti përdor nga gjdo vend dhe në qfardo kohe,të zgjedhur prej secilit⁹³.

5.2 E drejta e shpërndarjes së veprës

E drejta e shpërndarjes së veprës orgjinale ose të kopjeve të saj shuhet,kur kjo e drejtë ushtrohet nga titullari i kësaj të drejtë ose me miratimin e tij,nëpërmjet shitjes së parë ose me gjdo mënyrë tjetër për kalimin e pronësis dhe vetëm kur këto veprime e zhveshin atë nga e drejta e rishpërndarjes së veprës në vazhdimësi si dhe nga e drejta e qeradhënies⁹⁴.

⁹³ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura më të neni 13,shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

⁹⁴ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 14,shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

5.3 Përfshirje nga e drejta e qeradhënies dhe huadhënies

1.Përfshihen nga e drejta e qeradhënies vënia në dispozicion e veprës,me qëllim ekspozimi, reklamimi ose përcjellje në publik nëpërmjet fonogrameve ose regjistrimeve audiovizuale(videograme),përfshi këtu de pjesë të secilit prej tyre,si dhe vënia në dispozicion për konsultim në vend.

2.Përfshihen nga e drejta e huadhënies vënia në dispozicion e veprës,me qëllim ekspozimi, reklamimi ose përcjellje në publik nëpërmjet fonogrameve ose regjistrimeve audiovizuale(videograme),përfshi këtu edhe pjesë të secilës prej tyre,si dhe vënia në dispozicion për konsultim me vend.

3.Konsiderohet se nuk ka përfitime ekonomike ose tregtar të drejtpërdrejt kur huazimi bëhet kundrejt shpërblimit në një vlerë,e cila nuk është më e madhe se ajo që shërbeu për të mbuluar shpenzimet e veprimeve për dhënien hua të veprës..

4.Pavarësisht nëse e drejta e qeradhënies apo e huadhënies së veprës i njihet prodhuesit të fonogramit,prodhuesve të veprave kinematografike,audiovizuale ose të sekuencave me pamje të lëvizshme, autori dhe/ose interpretuesit gëzojnë të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm për kontratën e qeradhënies apo të huadhënies,të nënshkruar nga prodhuesi me të tretët.Kjo e drejtë mund të ushtrohet edhe nëpërmjet të tretëve të autorizuar,të cilët përfaqësojnë autorët dhe/ose interpretuesit.

5.Parashikimet e këtij neni për qeradhënien ose huadhënien nuk janë të zbatueshme për veprat arkitekturore dhe veprat e arteve⁹⁵,të aplikuara.

5.4 Përcjellja në publik

Përbëjnë veprime të përcjelljes së veprës në publik:

- a)shfaqja skenike,recitimi dhe gjdo paraqitje gojore e ekzekutimi para publikut,i veprave dramatike,dramatiko-muzikore,letrare a muzikore,nëpërmjet qfardo lloj mjeteve procedimi.
- b)shfaqja në publik e veprave kinematografike dhe të veprave tjera audiovizuale.
- c)përcjellja e qfardo lloj vepërë përmes radiopërhapjes ose me qfardo mënyrë,që shërben për përhapje pa linjë të shenjave,tingujve ose pamjeve.

⁹⁵Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 15, Shpallur në dekretin nr.4587 Tiranë 2005

q)radiopërhapja ose përcjellja në publik me satelit e qfardo lloj vepëre,nën kontrollin dhe përgjegjësin e organizatës së radiopërhapjes ose të satelitit,të destinuara për tu kapur nga publiku.

d)transmetimi në publik i qfardo lloj vepëre me tel,rrjet kabllorfibër optike ose gjdo mënyr tjetër që mundson ose jo shpërblimin.

dh)emëtimi ose transmetimi në një vend të hapur për publikun,me anë të qfardo lloj mjete të përshtatshëm,i veprës së përhapur përmes radios.

e)ekspozimi publik i veprave të artit ose i riprodhimeve të tyre.

ë)përcjellja ose hapja e bazës së të dhënave duke i bërë të disponueshme për publikun,nepërmjet mënyrave të mësipërme,pavarsisht nëse kjo bazë përmban dhe\ose është vepër e mbrojtur.

2. Nuk vlerësohet si përcjellje në publik përcjellja që ndodh brenda rrethit të ngushtë familiar dhe që nuk integrohet e as lidhet me një rrjet përhapje të gjdo lloj natyre⁹⁶.

5.5 Ndryshimi i veprës

1.Autori ka të drejtën ekskluzive të autorizoj gjdo përshtatje,përpunim dhe ndryshim si dhe përkthim që mund ti bëhet veprës së tij.

2.Të drejtat e autorit mbi veprën e prejardhur i përkasin autorit të ri,vetëm nese është marrë autorizimi nga autori apo titullari i të drejtave mbi veprën orgjinale,ndërsa shfrytëzimi i saj mund të bëhet vetëm duke mos cenuar të drejtreat e tyre mbi veprën orgjinale⁹⁷.

5.6 E drejta e vazhdimësis

1.Autorët e veprave të arteve të bukura kanë të drejtën e vazhdimësis mbi veprën e shitur,për të përfutuarë nga shitësi jo më pak se 5 për qind të shumës nga gjdo rishitje e veprës,por në asnjë rast jo më pak se 5000 lekë.

2.E drejta e njohur në pikën 1 të këtij neni mund të kalohet vetëm me anë të trashigimisë.

⁹⁶ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 16,shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

⁹⁷ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 17,shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

3.Rishitësit detyrohen të njoftojnë organizatën administruese të veprës përkatëse ose sipas autorin a personat,që gëzojnë të drejtat e autorit mbi veprën,brenda 30 ditëve,duke filluar nga data e rishitjes,dhe të depozitojn dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që të paguhet shpërblimi i të drejtës së vazhdimësisë.

Po ashtu kur ata vepronjë për llogari ose si përfaqësues të shitësit paraardhës,ata janë bashkërisht përgjegjës për shpërblimin e të drejtës dhe për këtë arsye detyrohen të llogarisin në qmimin e rishitjes pjesën përkatëse të shpërblimit të autorit.

4.E drejta për të kërkuar të dhëna për të drejtën e vazhdimësisë mbi veprën parashkruhet brenda 3 viteve,duke filluar nga data e njoftimit të shitjes por jo më vonë se 5 vjet që nga data e shitjes,nëse nuk është kryer njoftimi⁹⁸.

1.Autori ka të drejtë ekskluzive për shfrytëzimin pasuror të veprës së tij në qfardo forme,si dhe t’ia lejojë apo ndalojë personave të tjerë shfrytëzimin e veprës së tij,nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

2.Personat e tjerë mund të shfrytëzojnë veprën e autorit vetëm në bazë të autorizimt të autorit për kalimin e të drejtave ekskluzive dhe me kushtet e vendosura prej tij,nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

3.Për gjdo kalim të të drejtës për shfrytëzimin e veprës,autorit i takon kompenzimi,nëse me këtë ligj ose me kontrat nuk parashihet ndryshe⁹⁹.

1.Vepra e autorit mund të shfrytëzohet në formë lëndore,jolëndore dhe të modifikuar.

2.Shfrytëzimi i veprës në formë lëndore përfshinë në veqanti të drejtat ekskluzive të autorit si në vijim:

- 2.1 të drejtën e riprodhimit
- 2.2 të drejtën e shpërndarjës
- 2.3 të drejtën e qiradhënies

5.7 Shfrytëzim i veprës në formë jolëndore

Përfshinë në veqanti të drejtat ekskluzive të autorit si në vijim:

- 3.1 të drejtën e interpretimit publik
- 3.2 të drejtën e shfrytëzimit nga “Shërbyesit medial audiovizuel”

⁹⁸ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni 18,shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

⁹⁹ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 21,Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

3.3 të drejtën e komunikimit publik me anë të fonogrameve dhe videogrameve

3.4 të drejtën e shfaqjes publike

3.5 të drejtën e vënies së veprës në dispozicion të publikut

4.Shfrytëzimi i veprës në formën e modifikuarë përfshinë në vaqanti të drejtën ekskluzive si në vijim:

4.1 Të drejtën e përpunimit

4.2 Të drejtat audiovizuele

5.8 Shfrytëzimi i veprës në formën lëndore

1.E drejta e riprodhimit është e drejtë ekskluzive e autorit që të lejoj apo ndaloj fikësimin e veprs së tij ose të ekzemplarit të veprës në mbajtës lëndor,të bërë drejtpërdrejt ose tërthorazi,përkohëshëm apo përhershëm,në qfardo forme apo mënyre,në tërësi ose pjesërisht dhe pavarsisht nga numri i ekzemblerëve.

2.Vepra është e reprodukuarë kur bëhet përmes shumëzimit grafik,riprodimit tredimensional,shkrirjës,fotografimit,fikësimit audio ose video,regjistrimit elektronik.

3.Ndërtimi i objektit arkitekturor sipas projektit konsiderohet akt reprodukimi¹⁰⁰.

5.9 E drejta e shpërndarjës

1.E drejta e shpërndarjës është e drejtë ekskluzive e autorit për ta autorizuarë apo ndaluarë vënien në qarkullim të veprës orgjinale apo kopjet e veprës së tij përmes shitjes apo ndonjë formë tjetër të bartjes së pronësis,përfshirë ofrimin e tyre publikut për qëllim të tillë.

2.Me shitjen e parë ose bartjen në formë të pronësisë për orgjinalin apo kopjen e veprës,të bërë nga autori ose me pëlqimin e tij,e drejta e shpërndarjes për atë orgjinal apo kopje të veprës shteret për teritorinë e Republikës së Kosovës¹⁰¹.

¹⁰⁰ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 23-Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

¹⁰¹ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 24-Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

5.10 E drejta e qeradhënies

1.E drejta e qeradhënies është e drejta ekskluzive e autorit ta lejojë apo ta ndalojë që origjinali apo ekzamplerët e veprës së tij të jepen në shfrytëzimin për afat të caktuar,përmes përfitimit të drejtpërdrejtë apo tërthortë pasurorë.

2.Dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohen për shfytëzimin e:

2.1 veprës së ndërtuar arkitekture

2.2 origjinalit ose të ekzemplarëve të veprave të arteve aplikative dhe të dizajnit industrial

2.3 veprës në rast të shikimit të atypëratyshëm,orgjinalit ose të kopjeve të saj në hapsira të institucionit.

3.Autori i cili të drejtën e vet të qeradhënies ia ka kaluar prodhuesit të fonogrameve ose precedentit të filmit mbanë të drejtën e kompensimit të drejtë nga qeradhënia¹⁰².

Shfrytëzimi i veprës në formën jolëndore.

1.E drejta e interpretimit në publik është e drejtë ekskluzive e autorit për ta lejuar ose ndaluar recitimin publik,ekzekutimin muzikor publik ose shfaqjen publike të veprës së vet.

2.E drejta e recitimit në publik është e drejtë e komunikimit të veprave të shkruara apo gojore përmes recitimit apo leximit të drejtpërdrejtë para publikut.

3.E drejta e ekzekutimit muzikor publik është e drejta e komunikimit të veprës muzikore përmes ekzekutimit të drejtpërdrejtë parapublikut.

4.E drejta e shfaqjes publike është e drejta e komunikimit të veprave skenike drejtpërdrejtë para publikut.

5.11 E drejta e transmetimit publik

E drejta e transmetimit publik është e drejtë ekskluzive e autorit të lejojë apo të ndalojë që recitimet,interpretimet ose shfaqjet e veprës së tij t'i transmetohen përmes altoparlantit,ekranit ose një mjeti tjetër,publikut që gjendet jashtë vendit ose hapsirës burimore.E drejta e komunikimit publik me fonogramet ose videogramet.

¹⁰² Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 25-Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

E drejta e komunikimit publik me anë të fonogrameve ose videogrameve është e drejtë ekskluzive e autorit të lejojë apo të ndalojë që vepra e tij e cila është e fikësuarë me fonogram apo videogram, t'i komunikohet publikut me anë të mjeteve teknike për riprodhim audiovizuel.

5.12 E drejta e paraqitjes publike

E drejta e paraqitjes publike është e drejtë ekskluzive e autorit të lejoj apo ndaloj që me anë të mjeteve teknike ti komunikohet publikut vepra e tij audiovizuele, vepëra fotografike, vepra figurative, veprat e arteve aplikative dhe dizajnit industrial, vepëra koreografike dhe prezantimit shkencor apo teknik¹⁰³.

5.13 Trasmetimi dhe ritransmetimi i përmbajtjeve programore audiovizuele

1. Shërbimet mediale audiovizuele të licencuara nga komisioni i pavarur për media KPM si edhe operatorët kabllor dhe operatorët tjerë që pavarësisht teknologjisë së përdorur ofrojnë përmbajtje audiovizuele, obligohen të bëjnë transmetimin e programeve bazuarë në marrëveshjet valide për të drejtën e autorit.

2. Marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjë me transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audiovizuele do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave të cilat licencohen nga Zyra për të drejtën e autorit pranë Ministrisë së Kulturës, në pajtim me nenin 171 të këtij ligji.

3. Të gjitha ankesat që kanë të bëjë me shkeljen e të drejtës së autorit gjatë transmetimit dhe ritransmetimit të programeve nga ana e shërbimeve me përmbajtje audiovizuele do të procedohen tek Komisioni i Pavarur për Media KPM¹⁰⁴.

4. Mospërmbushja e obligimeve dhe përgjegjësisë nga ana e shërbimeve mediale audiovizuele për transmetimin dhe ritransmetimin e programeve siq përcaktohen me këtë ligj do të shqyrtohet nga KPM-ja në pajtim me dispozitat e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.

¹⁰³ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nenet 27,28,29-Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

¹⁰⁴ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 30-Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

5.14 Programet e koduara

Nëse sinjalet që bartin programin janë të koduara, komunikimi për publikun me anë të satelitit, apo platëformave tjera bëhet me kusht që mjetet për dekodim të transmetimit sigurohen për publikun nga shërbimi medial audiovizual apo me pëlqimin e tij.

5.15 E drejta në emetim sekondar

E drejta e emetimit sekondar është e drejtë ekskluzive e autorit ta lejojë apo ta ndaloj komunikimin për publikun të një vepëre emetuese apo veprës që i është vënë në dispozicion publikut përmes autopërtlantit, ekranit ose një mjeti të ngjashëm.

5.16 E drejta e vënies së veprës së dispozicion të publikut

E drejta e vënies së veprës në dispozicion të publikut është e drejtë ekskluzive e autorit ta lejoj apo ta ndaloj që vepëra e tij t'i vihet në dispozicion publikut përmes përcjelljes linerare dhe jolineare, në mënyrë e cila mundëso individit që veprës t'i qaset nga vendi dhe në kohë që aj të zgjedhë¹⁰⁵.

5.17 Shfrytëzimi i veprës në formë të ndryshuarë

1. Shfrytëzimi i veprës në formën e ndryshuar përfshinë:

1.1 të drejtën e përpunimit 1.1.1 e drejta e përpunimit është e drejtë e autorit të lejojë apo të ndaloj përkthimin, përshtatjen skenike, përshtatjen muzikore apo përpunimin e veprës së tij në mënyrë tjetër, me qëllim të krijimit të një vepre të prejardhurë.

1.1.2 e drejta e parashikuarë në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet edhe në rastet kur vepëra e autorit, në formë të pandryshuar, përfshihet apo ngërthehet në një vepër të re.

¹⁰⁵ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nent 31,32,33-Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

1.1.3 autori i veprës burimore mban të drejtën ekskluzive për shfrytëzimin e veprës së tij në verzionin e përpunuarë nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj ose me kontratë.

1.2 të drejtën e përshtatjes audiovizuale

2.E drejta e përshtatjes audiovizuale është e drejtë ekskluzive e autorit ta lejoj apo ta ndaloj që vepra e tij të përshtatet apo të shfrytëzohet për tu fiksuar në vepër audiovizuale¹⁰⁶.

Autori gëzon të drejtën ekskluzivetë shfrytëzimit të veprës së tij në qdo formë dhe mënyrë.

Autori gëzon të drejtën ekskluzive për ta shfrytëzuar veprën e tij në formë materiale dhe jomateriale.

Autori gëzon të drejtën ekskluzive duke pasur parasysh veprën e tij në tërësi ose pjesërisht për të autorizuar, riprodhimin, shpërndarjen në publik, importimin, qeradhënien, huapërdorjen e të tjera.

E drejta e shfrytëzimit të veprës është ekskluziviteti i autorit, deri në momentin që ai ia kalon me kontratë ekskluzive personave të tjerë.

Këto lloj kontratash kanë filluar të bëhen evidente në praktikën shqipëtare, duke dëshmuar për dëshirën e subjekteve botuese për të respektuar të drejtën e shfrytëzimit të veprës të autorëve të huaj ku përfshihet përkthimi i veprës, botimi, përshtatja, shpërndarja, etj.

Kuptohet si gjido dukuri e re edhe këto kontrata do të shoqërohen me fenomenin e shkeljes së tyre nga të tretet dhe kjo është arsyeja që janë bërë prezente në gjykatën shqipëtare¹⁰⁷.

5.18 Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë-ZDA

Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, është organ administrativ i themeluarë me rregulloren e Qeverisë së Kosovës nr.01/2010 në qershor të vitit 2010.

¹⁰⁶ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 34-Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012

¹⁰⁷ http://www.te_drejtat_pasurore_në_Shqipëri.com

Zyra vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit dhe veprimtarinë e saj e ushtron në bazë të ligjit¹⁰⁸.

Komponentat e zyrës janë të parapara me ligj¹⁰⁹, respektivisht veprimtaria themelore e zyrës është dhënja e lejës për shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave, mbikëqyrja e veprimtarisë dhe aktivitetëve të shoqatave për administrim të të drejtave marrja e lejes së dhënë të shoqatës për administrim të të drejtave, promovimi dhe ndërmarrja e aktivitetëve për dhënien e informatave të duhura të autorëve, bartësëve të të drejtave dhe opinionit të gjërë lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, përcjellja e legjislacionit ndërkombëtarë dhe dhënien e rekomandimeve përkitazi me fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

Është më rëndësi të potencohet fakti së Zyra nuk ka kompetenca ekzekutive në kontestet e zbatimit të të drejtave të autorit, respektivisht për të gjitha pretendimet lidhur me shkeljet e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, autorët dhe mbajtësit e të drejtave duhet të ju drejtohen organeve kompetente, gjykatave, prokurorit kompetente, dhe inspektoriatit të tregut.

Zbatimi i ligjit- Fillimisht aktivitetet e Zyrës janë bazuarë në nxjerrjen e akteve nën-ligjore, me anë të të cilave janë rregulluarë qështjet e caktuara.

Zyra ka miratuarë rregullorën për dhënien dhe marrjen e lejes për shoqatat e administrimit kolektiv të të drejtave, dhe rregulloren për ndërmjetsimin e kontesteve për qështjet nga e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta.

5.19 Rregullorja për dhënien e lejeve për Shoqatat për administrim Kolektiv të të Drejtave

Me këtë rregullore, janë përcaktuarë procedurat për dhënien e lejës për administrim kolektiv të të drejtave, kushtet të cilat një shoqatë e themeluarë duhet ti plotësoj për aplikim, procedurat e monitorimit të shoqatave nga ana e Zyrës dhe në rast të shkeljeve nga ana e shoqatave është paraparë edhe marrja e lejës për administrim kolektiv të të drejtave.

¹⁰⁸ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr 04/L-065,30 në fuqi nga dhjetori i vitit 2012, i cili është i harmonizuarë me Legjislacionin e Bashkimit Evropian respektivisht me rregullat dhe direktivat e BE-së, si dhe me legjislacionin ndërkombëtarë të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta-Prishtinë

¹⁰⁹ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr 04/L-065,30 në fuqi nga dhjetori 2012 neni 171-Prishtinë

Licencimi i Shoqatave për Administrimin Kolektiv të të Drejtave-Zyra në korrik të vitit 2012 ka lëshuarë lejen për administrim kolektiv të drejtave¹¹⁰, dy shoqatat e para në Rep. e Kosovës. Shoqatës për administrimin e të drejtave në fushën e muzikës, e cila përfaqëson Autorët, Prodhuesit dhe Interpretuesit e Kosovës, e njohur me shkurtesën APIK. Dhe shoqatës për administrimin e të drejtave në fushën e veprave audio-vizuele, e cila përfaqëson Autorët, Prodhuesit dhe Interpretuesit e Kosovës e njohur me shkurtesën VAPIK. Rregullorja për ndërmjetësimin e kontesteve në fushën e të drejtës së autorit-procesi i ndërmjetësimit ofron zgjedhje alternative të kontesteve të caktuara.

Procesi i përcaktimit të tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e të drejtave të autorit kalon në disa faza, njëra nga fazat e mundsme të zhvillimit të këtij procesi është edhe ajo e ndërmjetësimit. Nëse njëra fazë nuk është e suksesshme vazhdohet me fazën tjetër.

Faza e parë është ajo e negociatave ndërmjet shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave dhe përfaqësuesve të shfrytëzuesve. Faza e dytë në rast se me negociatat nuk arrihet marrëveshje për tarifën, atëherë ligji ka paraparë si fazë obligative ndërmjetësimin ndërmjet palëve të lartpërmendura.

Me qëllim të zbatimit të ligjit, zyra ka hartuar rregulloren për ndërmjetësim e cila është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kjo rregullorë përcakton procedurat e ndërmjetësimit në mes të shoqatave kolektive dhe përfaqësuesve të përdoruesve, lidhur me arritjen e marrëveshjes gjithëpërfshirëse për tarifën e përgjithshme për përdorimin e veprave të autorëve. Me qëllim të fuqizimit të sistemit të së drejtës së autorit, dhe të krijimit të mekanizmit të ndërmjetësimit për përcaktimin e tarifave të përgjithshme, Zyra bazuar në ligj dhe në rregulloren përndërmjetësim ka bërë thirrje për aplikim të gjithë ndërmjetësve të licencuar nga Ministria e Drejtësisë dhe të cilët kanë plotësuar kushtet e parapara me rregulloren për ndërmjetësim në të drejtën e autorit. Pas vlerësimit të dokumentacionit relevant të pranuar nga aplikuesit dhe përfundimit të intervistave, komisioni ka përzgjedhur shtatë ndërmjetës.

Zyra ka organizuar një trajnim të avancuar për shtatë ndërmjetës të përzgjedhur, të mbajtur nga avokati i njohur kroat z. Mladen Vukmir i cili është ndërmjetës i vetëm në rajon nga Organizata Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale.

¹¹⁰ Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të drejta e përafërta, parasheh dy forma të administrimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. Administrimi individual i të drejtave nëni 158 i Ligjit sipas të cilit të drejtat administrohen nga vetë individit apo nëpërmjet përfaqësuesit të tij në bazë të autorizimit përkatës. Administrimi kolektiv i të drejtave bëhet nga shoqatat për administrim kolektiv të licencuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Rep. e Kosovës.

Ndërmjetësit e trajnuarë janë emëruarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e saj të mbajtur më 05.04.2013 dhe janë të gatshëm të ndërmjetësojnë konkretisht nëse nuk arrihet marrëveshje në fazën e negociatave.

Bashkpunimi Ndërkombëtarë-Zyra që nga momenti i themelimit ka venë mardhënie bashkpunimi më zyrat nga rajoni dhe më gjerë. Është mirë të përmendet bashkpunimi i shkelqyerë me Zyren Shqipëtare për të Drejtën e Autorit, me të cilën janë shkëmbyer vizita të ndërsjellta. Në këtë kontest zyra ka bashkpunuar edhe me zyrën e të drejtave të autorit të Danimarkës, Hungarisë, Sllovenisë, etj. Zyra dhe Komisioni Evropian-Raportet e Zyrës me përfaqësuesit e Komisionit Evropian në Kosovë janë të shkelqyeshme dhe zhvillohen përmes takimeve të rregullta. Gjithashtu duhet përmendur Studimin e Fizibilitetit për vitin 2012, ku vlerësohet lartë puna dhe aktivitetet e Zyrës, ku vlenë të përmendet vlerësimi pozitiv i Komisionit Evropian lidhur me hartimin e strategjisë kundër Piratërisë, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe krijimin e raporteve të bashkpunimit të zyrave. Komisioni Evropian ka financuar projektin Fuqizimi i Sistemit të Pronësisë intelektuale në Kosovë me 5 shkurt 2013. Zyra për të drejtat e autorit është përfituese dhe priten përmirësime në përafrimin e legjislacioneve¹¹¹, të ngritjes së kapaciteteve në ZDA, të ngritjes së kapaciteteve për organet e zbatimit të ligjit, dhe të ngritjes së vetëdisimit.

Drejtori i shoqatës kolektive VAPIK, Blerim Gjoci, ka thënë fillimi i themelimit të shoqatës ka qenë shumë i vështirë, pasi që ka qenë e pamundur të bindet komuniteti artistik si dhe menzëxhimi kolektiv i të drejtave të autorit sepse nga ana e tyre kjo është parë me skepticizëm. Por sipas Gjocit edhe pse ka nga artistët që akoma janë skeptik në këtë kontest sipas tij deri më tani gjdo që ka shkuar sipas planit dhe se numri i të antarsuarve është mjaft i kënaqshëm.

Qëllimi i themelimit të shoqatave kolektive për menagjimin e të drejtës së autorit-Pas shkatërrimit të Jugosllavisë, pjesët e ndara të sajë dikush më heret e dikush më vonë përqaftuan sistemin evropian të të drejtave të autorit.

Në Kosovë një gjë e tillë fatkeqësisht u zhvillua me një hap më të ngadalt që rezultoi edhe me një funksionalizim të vonshëm të kësaj praktike Evropiane.

¹¹¹Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta në Republikën e Kosovës.

Në Evropë, pra edhe në vendin tonë autorët, interpretuesit dhe producentët, mbledhen në shoqata të specializuara për mbrojtjen dhe menaxhimin e të drejtave të tyre dhe të ardhurave nga këto të drejta. Po të ishte që secili autor, interpretues apo producent të ndiqte të drejtat dhe të menaxhonte ato personalisht, atëherë shpenzimet që krijohen nga një gjë e tillë do të tejkalonin të ardhurat që gjenerohen. Për këtë ka lindur nevoja e krijimit të shoqatave të tilla gjdo kund nëpër botë të cilat bëjnë menaxhimin kolektiv të këtyre të drejtave. Një ndër vështërsit kryesore të shoqatës së parë kolektive në Republikën e Kosovës ka qenë bindja e komunitetit artistik, interpretuesve dhe producentve Kosovarë se formimi i shoqatave kolektive dhe menaxhimi kolektiv i të drejtave të autorit , nga ana e tyre është e mundur.

Komuniteti artistik vazhdon të jetë skeptik në faktin se nëse shfrydzuësit do të paguajnë dhe nëse organet shtetërore do të imponojnë një zgjedhje nëse këta shfrytëzues përfundimisht refuzojnë të kryejn obligimet e tyre ligjore. Ky skepticizëm ka vështërsuar edhe komunikimin dhe anëtarimin e shumë antarve të shoqatës, sepse nuk besojnë në ndonjë përfundim pozitiv. Shoqata VAPIK, Ka dy borde të cilat janë formuarë në harmoni të plotë me shoqatat si motor të rajonit dhe BE-së. Bordi ekzekutiv dhe bordi mbikëqyrës.

Bordi ekzekutiv është i detyruar që tu përgjigjet kërkesave dhe dyshimeve të bordit mbikëqyrës, dhe është organi më i lartë ndërsa bordi mbikëqyrës mbikëqyr punën e shoqatës dhe distribucionin e të ardhurave¹¹², nga e drejta e autorit.

5.20 Zyra shqipëtare për të drejtat e autorit në Shqipëri ZSHDA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ,dhe të pikës 2 të nenit 117 të ligjit nr.9380, datë 24.04.2005”Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinis dhe të Sporteve, Këshilli i Ministrave vendosi: Statusi dhe objektivi i veprimtarisë së zyrës shqipëtare për të drejtat e autorit-Zyra Shqipëtare për të drejtat e autorit ZSHDA, është institucion qëndror, me statusin e personit juridik publik, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me seli në Tiranë.

¹¹²hppt\\ www.vapik.org-

ZDSHA-ja ka vulën dhe logon e vet,të cilat miratohen nga titullari në përputhje me vendimin nr 474 datë 10.07.2003 për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.ZDSHA-ja ushtron në veprimtarinë në mbështetje dhe në zbatim të Kushtetutës,të legjislacionit shqiptarë për të drejtën e autorit de të drejtat e tjera të lidhura me të në dispozitat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi si dhe me konventat e marvëshjet e tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

ZDSHA-ja si objekt i veprimtarisë mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me të nga subjektet personat fizik\juridik,privat e publik,përdorues të pronësis letrare,artistike,shkencore¹¹³.Për përmbushjen e funksioneve pranë qdo qarku,krijohen zyrat raionale të së drejtës së autorit më tej ZRDA të cilat janë struktura në varësi administrative të ZDSHA-së.ZRDA-ja ka logon dhe vulen e vet në përputhje me përaktimin e bërë në piken 1 të këtij vendimi ku shtohën fjalët Zyra rajonale për të drejtat e autorit dhe qarku.ZRDA-ja nepërmjet inspektorve kontrollon autorizimet dhe lejet përkatëse të lëshidhura huara nga autorët,titullarët e të drejtave të autorve apo të agjencioneve të menagjimit kolektiv,ndaj përdoruesve të pronësis artisitke,kulturore a shkenëcore,dhe vendosin gjobat në përputhje me nenin 130 të ligjit nr 9380 datë 28.04.2005 .

Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të¹¹⁴,brenda kufijëve administrativ të qarkut ku ushtron veprimtarinë zyra rajonale e të drejtave të autorit.

5.21 Detyrat dhe përgjegjësit e ZSHDA-së

Shqyrëton dhe regjistron gjdo aplikim për regjistrim të së drejtës së autorit dhe të drejtave tjera të lidhura me të,për subjektin aplikues autor apo titullar i të drejtave të autorit mbi një vepër.Dispoziton të gjitha aplikimet regjistrimet dhe ndryshimet e të drejtave të autorit të cilat i mban në bazën e të dhënave që administrohen në Regjistrin e të Drejtave të Autorit një regjistër ky dokumentar elektronik.

Qertifikon gjdo marëveshje apo kontratë të lidhur apo të ndryshuarë,nepërmjet palëve,subjekteve të ligjit nr 9380 datë 28.04.2005 .

¹¹³ Vendim për krijimin dhe funksionimin e zyrës shqiptare për të drejtat e autorit Rep. e Shqipërisë,vendimi nr.232 datë 19.04.2006

¹¹⁴ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të neni ,shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të,ku objekt i kontratës janë të drejtat mbi veprën dhe\ose kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën,në rast përdorimi,shfrytëzimi,ripordhimi,shpërndarje apo përcjellje në publik,në përputhje me nenet 45/1,47 e 51/3.Për zbatimin sa më efektiv të këtij ligji pranë ZSHDA-së,regjistrohen dhe qertifikohen të gjitha kontratat për kalimin në formën ekskluzive,të të drejtave pasurore mbi një vepër,të qfardolloji duke i paisur me pullën artistike të gjitha kopjet e veprave të cilat janë rezultat i riprodhimit nga një kopje orgjinale¹¹⁵.

Ofron shërbime të specializuara,kundrejt tarifave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për gjdo subjekt të interesuarë bën ekspertizën dhe jep vlerëimin me shkrim për gjdo rast konflikti ndërmjet palëve që kanë objekt të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.Përcakton me kërkesë të autorit shpërblimin për kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën ndërmjet autorit dhe ose titullarit të të drejtave të autorit dhe të palës tjetër kontraktuese,sipas objektit të kontratës,në rast se ky shpërblim nuk është parashikuarë shprehimisht në kontratën e lidhur ndërmjet palëve sipas neneve 34\2 e 68\3 të ligjit në fuqi¹¹⁶.Shqyrton dhe jepë shpjegim përfundimtar,me shkrim për kërkesën e autorit,për veprën që pretendohet se është përdorur,shfrytëzuar,ndryshuar,riprodhuarë,shpërndarë apo përcjellë në publik,në kundërshtim me dispozitat e ligjit.Nr 9380 datë 28.04.2005 Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.Shqyrëton mosmarëveshjet për të drejtën e autorit dhe të drejta e tjera të lidhura me të në përputhje me nenin 104 të ligjit.

Cakton ekspertët e së drejtës së autorit pranë organeve gjyqësore,sipas fushave përkatëse mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile¹¹⁷.

Mbikëqyrë veprimtarinë dhe zbatimin e detyrimeve ligore të agjencive të administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të,dhe nëse vëren shkelje të detyrimeve ligjore,vepron në përputhje me nenin 116 të ligjit.Shqyrëton kërkesat e të interesuarve për tu licencuarë në fushën e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit,bënë kontrollimin e dokumentacionit të paraqitur,zhvillon hetim të plotë administrativ dhe i paraqet Ministrit të Turizmit,Kulturës,Rinisë dhe Sporteve dosjen e aplikimit,relacionin dhe mendimin e vet për përmbushje ose jo të kushteve për tu paisur -

¹¹⁵Vendim për krijimin dhe funksionimin e zyrës shqipëtare për të drejtat e autorit Rep. e Shqipërisë,vendimi nr.232 datë 19.04.2006

¹¹⁶ Ligji mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të Rep.E Shqipërisë shpallur ne dekretin nr.4587 Tiranë 2005

¹¹⁷ Kodi I Procedures Civil- cip katalogimi ne botimin bk Tiranë,Qendra e publikimeve zyrtare 2007

me licencë në përputhje me nenin 108 të ligjit. Rregullon dhe qertifikon gjdo kontrat të lidhur ndërmjet autorit/autorëve apo titullarit të të drejtave të autorit dhe të agjensisë së administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të. Vëndos pullën artistike të ZSHDA-së dhe depozito një kopje origjinale të mbajtësit fotografik\videogramit ose të mjetit të ngjashëm me të për riprodhimin e tyre, si dhe ushtron kontroll për respektimin e të drejtave të autorit, e prodhuesve apo shpërndarësve të kopjeve të autorizuara të fonogrameve në përputhje me nenin 60 të ligjit.

Bashkpunon me organet tatimore, doganore, gjyqësore, dhe me institucionet e tjera publike, si dhe me organizatat private, që përfaqësojnë përdoruesit e ndryshëm të pronësisë artistike, kulturore dhe shkenëcore për ato që është që paraqesin interes të përbashkët për mënyrën e respektimit dhe të zbatimit të së drejtës së autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendos marrëdhënie bashkpunimi me organizatat e ndryshme dhe institucione homologe jashtë vendit.

Propozon për përmirsimin e akteve ligjore, nënligjore në fushën e së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe ia paraqet Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve¹¹⁸. Bëhet buletin periodik ku jep informacione, analiza, studime dhe që është të tjera e të së drejtës së autorit dhe vë në dijeni publikun nëpërmjet website-it për veprimtarinë dhe misionin që ka në fushën e të drejtave të autorit.

5.22 Të drejtat e autorit në Shqipëri-ndërgjegjësimi

Po të kthjmë kokën pas, për të kuptuar se ku kemi arritur dhe qfarë rruge kemi përshkruar në fushën e së drejtës së autorit, do të shohim se krijimtaria në fushën letrare, muzikore, në artet e bukura e të tjera, ka lindur shumë, shumë më heret se sa e drejta dhe legjislacioni i krijuar dhe aprovuar për të rregulluar mbrojtjen e saj. E drejta e autorit është një institut juridik relativisht i ri krahasuar me të institutet e njohura dhe rregulluar që nga e drejta romake¹¹⁹. Zhvillimi i legjislacionit modern mbi të drejtën e autorit u mbështet në përpjekjet ligjore që u kushtëzuan nga interesat tragtare për të marrë kontrollin e monopolit të industrisë botërore dhe të së drejtë prodhuese.

¹¹⁸ Vendimi për krijimin dhe funksionimin e zyrës shqiptare për të drejtat e autorit-Rep. e Shqipërisë

¹¹⁹ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 18-shtëpia botuese Skangerbeg books Tiranë 2009

Bashkimi Evropian e ka shtuar mbështetjen për mbrojtjen e të drejtave të autorit në Shqipëri. Në Shqipëri vërehet një ndërgjegjsim i opinionit për pronësinë intelektuale e të drejtave të autorit. Shqipëria ka detyrime evropiane. Në më shumë se dy dekada të tranzicionit në Shqipëri është i dukshëm liberalizimi në tregun e botimeve, të publikimeve dhe të transmetimeve të krijimtarisë audio e video të autorëve vendas dhe të huaj. Nga një vend i izoluar me censurë të pashembullt dhe me fobi ndaj produkteve përëndimore, që konsideroheshin si dekadente dhe kundër moralit të shoqëris shqipëtare u kalua në një situatë ku pronësia intelektuale nisi të qarkullojë pa kurrfarë problemi. Fondet muzikore, filmat, dokumentarët, botimet e literaturës më të mirë botërore, krijimtaria shkencore apo gjithëqka tjetër e krijuar nga autorët e huaj e vendas nisi të riprodhohej, shpërndahej, apo përvetësohej për qëllime fitimi ose jo nga gjithkush. Pa bërë asnjë procedurë paraprake për të marrë pëlqimin, pa paguar asgjë për këtë përdorim¹²⁰.

Cënimi i të drejtës së autorit bëhej jo vetëm nga tregtarë të vegjël buzë trotuareve, por edhe në veprimtari biznesi të strukturuar dhe me qarkullim të konsiderueshëm monetar, nga operator radio-televiziv, nga institucione shtetërore të të gjitha niveleve etj. Sipas drejtoreshës së Zyres Shqipëtare për të drejtat e autorit, Nikoleta Gjordeni, një nga synimet është forcimi i kapaciteteve operacionale të kësaj zyre nëpërmjet mbështetjes së stafit për të zbatuarë kompetencat e saj në mënyrë eficiente për të zbatuarë legjislacionin aktual dhe duke përmirësuar bashkpunim ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit.

Synimi tjetër është të sigurojmë përafërimin ligjor me standardet e BE-së dhe me praktikën më të mirë përmes transpozimit të duhur të ligjeve të BE-së dhe për të përmirësuar ligjet si të dobishme dhe të përshtatshme në fusha specifike në përputhje me praktikën më të mirë evropiane. Gjithashtu objektivë është rritja e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura përmes përdoruesve të veprave të mbrojtura më të drejtë autori, ose të drejtat e lidhura, mbajtësit e të drejtës, përfaqësuesit e tyre dhe komunitetin në përgjithësi. Alban Baqa për disa vite ka punuar si ekspert në një agjenci për të drejtat e autorit në fushën e muzikës, sipas tij situata në Shqipëri ka nisur të ndryshojë, por gjithsesi Beqa i përshkruan si hapa mjaft të ngadalshëm, ku situata është mjaft komplekse shprehet ai.

¹²⁰ http://www.te_drejtat_e_autorit_ne_shqiperi.com

Ka të bëjë me anën e respektimit të ligjit, që nuk është e panjohur dhe në sektorë të tjerë të jetës, por është shumë e theksuar në respektimin e së drejtës së -autorit. Ka të bëjë me mungesën e ndërgjegjësimit të mjaftueshëm të komunitetit të artistëve, këtu kam parasysh autorët, artistët që ekzekutojnë, këngëtarët, instrumentistët dhe orkestrantët dhe producentët. Mungon një regjistër i plotë nga ana ligjore për njohjen e pronësisë intelektuale. P.sh., sot po të kontaktosh me autorët më të famshëm të muzikës në Shqipëri, vë re që ata nuk janë ende të ndërgjegjësuar për detyrimet që ata kanë ndaj pronës së tyre. Në Zyrën Shqiptare të së Drejtës së Autorit e shikojnë me shumë optimizëm faktin e hartimit të një projektligji të ri për të drejtën e autorit, një projekt që ka kaluar të gjitha procedurat e hartimit dhe konsultimit me ekspertët vendas dhe të huaj, duke afruar këtë kuadër me atë të vendeve të BE-së¹²¹. Projektligji pas diskutimit dhe miratimit në parlament pritet që të ketë ndikim në ndryshimin e gjendjes.

Përpos kësaj ekziston dhe një kuadër i konsiderueshëm i akteve ndërkombëtare siç janë Traktatet dhe Konventat, të cila janë ratifikuar apo ku Shqipëria është palë, që jo vetëm plotësojnë ligjin shqiptar, por janë një referencë e mirë ligjore për shumë zbatimin e të drejtave dhe interpretimin e duhur të shumë rasteve të hasura në praktikën e punës së Zyrës. Alban Beqa mendon se përshpejtimi i hapave përmirësues në fushën e respektimit të të drejtës së autorit duhet të lidhet me angazhimet që ka vendi në procesin e integritetit evropian.

Ky aspekt është një kërkesë, një kushte më vete që Shqipëria duhet të tregojë me fakte, me rezultate konkrete, se ka një kuadër ligjor, por dhe një nivel zbatueshmërie të këtij kuadri në një nivel me vendet e BE-së. Në përkthime shkelen shpesh të drejtat e pronësisë "Qeverisja aktuale, por dhe ato të mëparshme mendoj se nuk kanë patur një vullnet të plotë që pronësia intelektuale duhet respektuar ashtu si e drejta pronësore në çdo fushë tjetër të jetës. Akoma edhe sot nuk ka një respektim të ligjit në këtë fushë qoftë dhe nga vetë strukturat përgjegjëse. Kur them se duhen bërë 'detyrat e shtëpisë' këto nuk duhen bërë për vetëm t'u bërë qejfin ndërkombëtarëve në Bruksel, por që efektet pozitive që vijnë ng respektimi i të drejtave autoriale ti ndiejnë në rradhë të parë ata që i meritojnë, të japin efekt në në mbarë demokratizmin e shoqërisë¹²².

¹²¹ http://www.te_drejtat_e_autorit_ne_shqipëri.com

¹²² http://www.te_drejtat_e_autorit_ne_shqipëri.com

- 6.Mbrojtja Gjyqësore e të drejtave të autorit

Në kuadër të mbrojtjes gjyqësore,titullari i së drejtës në rast të shkeljes së të drejtave mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave,përmes këtyre mjeteve juridike:

- Kërkesëpadia
- Masat paraprake
- Masat e përkohshme
- Sigurimi i provave¹²³.

6.1 Kërkesëpadia

Bartësi i së drejtës së autorit,atëher kur konsideron që i është shkelur e drejta e tij,ka të drejtë të ngrit padi në gjykatën kompetente e cila vendos për proceset lidhur me shkeljen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.Me anë të kërkesëpadis bartësi i së drejtës mund të kërkoj nga gjykata kompetente gjetjen e eksistimit të shkeljes së të drejtave.Në rast se e drejta e autorit shkelet në vazhdimësi,atëher bartësi i së drejtës mund të kërkoj nga gjykata,lëshimin e një vendimi që ndalon vazhdimin e shkeljes dhe të shkeljeve të përsëritura në të ardhmen.Bartësi i së drejtës me ane të kërkesëpadis ka të drejtë të kërkoj nga gjykata që me urdherin e saj të bëhet largimi nga tregu,dhe shkatërrimi i të gjitha mallrave të cilat janë krijuar si rezultat i shkeljes së të drejtave të autorit,po ashtu materialeve dhe mjeteve që janë përdorur për krijimin e mallrave që shkelin të drejtat e autorit.

Në rast se bartësit të së drejtës i është shkaktuar dëm material ,për shkak të shkeljes së drejtës së autorit,atëher bartësi i së drejtës mund të kërkoj nga gjykata që ti bëhet kompenzimi për fitimin e humbur ose zhvendim të posaqëm.

Përveq dëmit material,bartësit të së drejtës mund të i shkaktohet edhe dëmi jo material i cili nënkupton shkeljen e të drejtave morale,për të cilin po ashtu bartësi i së drejtës ka të drejtë të kërkoj kompensim.

¹²³ www.autori-ks.com

6.2 Masat paraprake

Bartësi i së drejtës duke u bazuar në nenin 184 të Ligjit, ka të drejtë të kërkoj nga gjykata që të ndërmerren masat paraprake për mbrojtje, nëse paraqet prova se të drejtat e tij ekskluzive janë shkelur, dhe zhdëmtimi ka gjasa të rrezikohet. Atëherë, bartësi ka të drejtë të kërkoj nga gjykata që të bëhet konfiskimi i përkohshëm i pronës së luajtshme dhe të paluajtshme dhe bllokimin e llogarive bankare të paditurit.

Si masë paraprake që mund të ndërmirret nga gjykata, sipas nenit 184, paragrafi 2¹²⁴, është sekuestrimi i dokumentave bankare financiare apo dokumentet komerciale të shkelësit.

Është me rëndësi të theksohet që bazuar në nenin 184, paragrafi 4, lidhur me masat paraprake zbatohet brenda tri(3) ditëve pas parashtrimit të kërkesës.

6.3 Masat e përkohëshme

Këto masa mund të urdhërohen nga gjykata, atëher kur bartësi i së drejtës me kërkesën e tij, paraqet prova të bazuara se i është shkelur e drejta e tij, apo egziston rreziku i pashmangshëm nga shkelja¹²⁵. Në bazë të nenit 185, par 1, pika 1 gjykata mund ti ndërmerr masat e përkohshme të cilat përfshijnë ndalesën e shkeljeve të pritura apo ndalesën e shkeljeve të pritura apo ndalesën e vazhdimit të kryerjes së shkeljes.

Bartësi i së drejtës mund të kërkoj nga gjykata që si masë të përkohshme, të urdhëroj konfiskimin ose heqjen nga qarkullimi të mallrave të dyshuar për shkeljen e një të drejte, dhe heqjen nga qarkullimi i materialeve që përdoren për krijimin e mallrave të dyshimta që shkelin të drejtën e autorit. Procedura e marrjes së masave të përkohshme nga ana e gjykatës është e shpejtë, konkretisht ato ndërmerren shtatë 7 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesëpadisë.

¹²⁴ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 184-Ligji nr 04/L-065, 30 Prishtinë 2012

¹²⁵ www.autori-ks.com

6.4 Sigurimi i provave

Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, neni 186, i jep të drejtë bartësit të së drejtës, i cili ka prova të bazuara se i është shkelur e drejta, dhe egziston rreziku i mundshëm që provat për shkeljen e të drejtës të shkatërrohen ose më vonë të jetë e pamundur të sigurohen, që të kërkoj nga gjykata të bëjë sigurimin e provave.

Masat të cilat merren për ruajtjen e provave përfshijnë marrëjen e mostrave, konfiskimin fizik të mallrave që shkelin të drejtat, inspektimin e vendeve, inspektimin ose konfiskimin e dokumenteve, egzaminimin e dëshmitarëve, emertimin dhe egzaminimin e ekspertëve. Gjykata e zhvillon procedurën lidhur me sigurimin e provave brenda shtatë (7) ditësh pas parashtrimit të kërkesës nga mbajtësi i të drejtës¹²⁶.

6.5 Cenimi i të drejtave të autorit

Neni 296 Kodit Penal të Republikës së Kosovës

1. Kushdo që nën emrin e tij apo të dikujt tjetër, shfaq apo në ndonjë mënyrë tjetër i kumton publikut punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, në tërësi apo pjesërisht, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që gjatë përdorimit të punës së mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjes së tjetrit, qëllimisht nuk cek emrin, pseudonimin ose shenjën e autorit apo të performuesit kur kjo kërkohet me ligj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.

3. Kushdo që e ndryshon, shtrembëron ose në ndonjë mënyrë tjetër e dëmton punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, dhe e shfaq në atë formë ose në ndonjë mënyrë tjetër ia kumton në formë të tillë publikut, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

4. Kushdo që paraqet ose në ndonjë formë tjetër ia kumton publikut në mënyrë të papërshtatshme punën e mbrojtur me të drejtën e autorit ose paraqitjen e tjetrit, që është paragjyquese për nderin dhe autoritetin e autorit ose performuesit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

¹²⁶ www.autroi-ks.com

5. Kushdo që pa autorizim përdor punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose temën e çështjes së ndërlidhur me këto të drejta, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
6. Nëse gjatë kryerjes së veprës penale nga paragrafi 5. i këtij neni, kryesi ka përfituar për vete ose për personin tjetër së paku dhjetë mijë (10.000) Euro por më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
7. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 5. i këtij neni përfiton për vete ose për personin tjetër më shumë se pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tetë (8) vjet.
8. Sendet dhe pajisjet për prodhimin e tyre nga ky nen konfiskohen¹²⁷.

6.6 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës

Neni 147 (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 44)

Vjedhja e pasurisë me anë të mashtrimit, duke paraqitur një vepër të artit dhe të kulturës si origjinale apo të një tjetër autori nga ai që është në fakt, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet

(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001,

Neni 45) Botimi ose përdorimi tërësisht apo pjesërisht me emrin e vet të një vepre letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 149 Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001,

Neni 46) Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i veprës letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, ose përdorimi i tyre pa pëlqim të autorit, kur kanë shkelur të drejtat vetjake e pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

¹²⁷ Kodi Penal i Republikës së Kosovës hyni në fuqi me 1 janar 2013-Kodi nr.04/L-82,20 prill 2012

6.7 Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale

Neni 149/a (Shtuar me ligjin nr. 23/2012)

Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i:

- a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës;
- b) produktit që mbrohet nga një dizeno industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjës industriale;
- c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare;
- ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik; të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet¹²⁸.

¹²⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë-Tiranë, Qendra e publikimeve zyrtare, 2010
ISBN 978-9928-01-020-9

Strategjia kundër falsifikimit dhe piraterisë 2012-2016 në Kosovë

Falsifikimi dhe pirateria janë veprime të cilat janë të ndaluara me ligjet pozitive në Kosovë. Sidoqoftë deri më tani nuk janë marrë veprime konkrete në luftimin e këtyre dy dukurive të cilat ndikojnë në ekonominë e tregut dhe zhvillimin ekonomik.

Duke parë që të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta janë të garantuara me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë dhe se cenimi i këtyre të drejtave paraqet vepër penale me të cilat janë parapë dispoziat ndëshkuese atëherë Qeveria e Kosovës konsideron se është e nevojshme hartimi i kësaj strategjie me të cilën do të sigurohej luftimi i piratërisë dhe luftimi e parandalimi i falsifikimit të produkteve në treg, të mbrojtura me të drejtat e autorit. Në këtë strategji si objektiva kryesore janë identifikuar: -Ulja e nivelit të piraterisë dhe falsifikimit, -Rritja e produktivitetit në industrinë kreative, -Identifikimi i problemeve dhe shkaqeve që ndikojnë në rritjen e piraterisë dhe falsifikimit, -Luftimin e ekonomisë joformale dhe krijimi i parakushteve për investime të huaja. Bashkpunimi ndërinstitucional në nivelin ndërkombëtar si dhe arritja e standardeve Evropiane. Të dyshuara për shkelje të drejtës së autorit, organizimi i anketave dhe hulumtimeve, përpilimi i raporteve në bashkpunim me organet e rendit dhe të drejtësisë, respektimin e të drejtës së autorit, pajisja me etika bar-kode të produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit, me rastin e regjistrimit të bizneseve, parandalimi i krimit të organizuar në fushën e piraterisë dhe të falsifikimit, rregullimi i procedurave të vënies së produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit në treg, takimet e rregullta të Këshillit Shtetëror për Pronësinë Intelektuale, Themelimi Task Forces shkëmbimi më shpesh informative, nënshkrimi i marrëveshjeve të mirkuptimit me institucionet përkatëse, antarsimi në organizatat ndërkombëtare, shkëmbimi i përvojave me vendet e rajonit, harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit vendor me atë evropian si dhe aplikimi i përvojave dhe metodave me efikasitet të përafërta me rajonin në luftën kundër piraterisë¹²⁹ e falsifikimit. Termi pirateri është i definuar në mënyra të ndryshme, varësisht nga shteti dhe kontesti i të përdorimit¹³⁰.

¹²⁹ Strategjia kundër falsifikimit dhe piraterisë 2012-2016-Rep. e Kosovës

¹³⁰ Organizatat Ndërkombëtare e Pronësinë Intelektuale, a egzistojnë definicione të pranura ndërkombëtare lidhur me piraterinë? Me08.01.2012 <http://ëëë.ipointo/enforcement/en/faq/counterfeiting/faq01.html>

Pirateria si term dhe definicion nuk është e përfshirë në legjislacionet vendore të shteteve mirpo piratëria është definuar vetëm në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare¹³¹. Pirateria përfshinë reprodukimin dhe shpërndarjen e kopjeve të mbrojtura me të drejtën e autorit, apo komunikimin dhe vënien në dispozicion të materialit të mbrojtur në internet, pa autorizim paraprak nga titullari i së drejtës, kur autorizimi i tillë është i nevojshëm në bazë të ligjit¹³². Në këtë kontest duhet potencuar faktin se nocioni i piraterisë nuk është i definuar me legjislacionin tonë vendorë, dhe për këtë arsye kjo strategji përdorë definicionin ligjor ndërkombëtar, përkatësisht definicionin e interpretuar në marrëveshjen Aspektet Tregëtare të të Drejtave të Pronësis Intelektuale TRIPS, konkretisht shënimit 14 për interpretimin e termit të përdorur në nenin 51 të marrëveshjes, sipas së cilës kemi këtë definicion: Materiale pirate janë materiale kopje të prodhimeve të mbrojtura me të drejtën e autorit të prodhuara pa lejen paraprake e titullarit të së drejtës e që konstituon shkelje të një të drejte të autorit apo të drejte të përafërta.

Definicioni për më tepër ka edhe elementin e qarkullimit tregëtar të materialit nga një vend në tjetrin, konkretisht nga vendi i prodhimit në vendime importimit, element ky që nuk është objekt i strategjisë. Në bazë të definicionit të përdorur në TRIPS¹³³, interpretim ky i pranuarë ndërkombëtarisht mund të nxirret në përfundim se edhe pse pirateria nuk është e sanksionuar me legjislacionin tonë, veprimet me të cilat kryhen shkeljet e së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta të bëra me qëllim dhe në shkallë komerciale, paraqesin veprime pirate dhe janë të ndaluara, konform dispozitave të Ligjit mbi të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, të kodit të penal të Kosovës. Legjislacioni vendor parashehë masa civile juridike, e me kodin penal parashihen edhe sanksjonet penale për të gjithë shkelësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta me të drejtën e autorit. Pirateria, është dukuri që ka të bëjë me shkeljen e të drejtave për veprat e ndryshme, si: veprat muzikore, veprat letrare, veprat filmike, veprat e programeve kompjuterike, veprat e video lojrave, veprat e bazës së të dhënave etj, të gjitha të mbrojtura me Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta.

¹³¹ UNESCO Cka është pirateria? Me 20.07.2012 <http://portal.unesco.org/culture/en/ev.php-URL ID=39397&URL DO=DO TOPIC&URL SECTION=201.html>

¹³² UNESCO Cka është pirateria? Me 20.07.2012 <http://portal.unesco.org/culture/en/ev.php-URL ID=39397&URL DO=DO TOPIC&URL SECTION=201.html>

¹³³ Aspektet Tregëtare të të Drejtave të Pronësis Intelektuale TRIPS, neni 51 shih shënimin 14, interpretimin lidhur me nocionin e piraterisë i paraqiturë në formë të fusnotës.

Strategjia për pronësin intelektuale 2010-2014 Në Kosovë

Duke marrë parasysh se roli i pronësisë intelektuale po zë vend gjithnjë më të madh në tregtinë ndërkombëtare dhe duke ditur rëndësinë e krijimit të një sistemi efikas për mbrojtjen jo vetëm të bartësve të të drejtave të pronës intelektuale por edhe shoqërisë në përgjithësi. Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë hapa drejt hartimit të strategjis shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale që synon krijimin e një infrastrukture moderne përmes ndërtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të saja institucionale dhe ligjore. Strategjia për Pronësinë Intelektuale e Republikës së Kosovës është një dokument politik i miratuar nga Qeveria e Kosovës që përcakton synimin dhe qëllimin e Kosovës në fushën e pronës intelektuale si dhe objektivat strategjike dhe masat për arritjen e këyre objektive në nivel shtetëror për periudhën 2010-2016¹³⁴. Strategjia për pronësin Intelektuale duhet të shihet si një arritje në drejtim të njohjes, administrimit dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga pronsia intelektuale, të drejta të cilat ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në funksionimin e ekonomisë së tregut si dhe ruajtjes dhe forcimit të rregullave të një konkurrence të drejtë.

Objektivi kryesor i Strategjisë për Pronësinë Intelektuale është përmirsimi i klimës investuese dhe stimulimi i zhvillimit ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend e cila synon ofrimin e një sistemi të besueshëm dhe stimulues të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale përmes zhvillimit dhe avancimit të kornizës ligjore dhe kapaciteteve industriale, të gjitha këto të orientuara për mbrojtje, mirmbajtje, zbatim dhe shfrytëzim sa me efikas të pronësis intelektuale. Strategjia për Pronësin Intelektuale paraqet edhe një shprehje të vullnetit politik të Republikës së Kosovës për hapjen e rrugëve drejt aderimit në organizatat dhe marveshjet ndërkombëtare në fushën e Pronësis Intelektuale. Kjo strategji ka vlerën e një platforme shtetërore që përcakton mënyrën e zhvillimit dhe implementimit të politikave në mënyrë të kordinuar nga grupet e ndryshme të interesit. Kjo konkretizon një nga përpjekjet më të rëndësishme për angazhimin intensiv profesional, vendosjen e dialogut gjithëpërfshirës dhe mirëkuptimin ndërmjet akterëve të ndryshëm, duke u ofruar mundësinë të gjithëve që të rrisin rolin e tyre në mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Strategjia synon krijimin e një kulture të mirfilltë të respektimit të pronës intelektuale përmes ngritjes së vetëdijës së shoqërisë Kosovare në lidhje me -

¹³⁴ <http://www.wipo.int/about/ip/en> Organizata Botërore për Pronësin Intelektuale WIPO- Strategjia për Pronësi Intelektuale 2010-2014 fq 11-MKRS Kosovë

PI(Pronësinë Intelektualë).Ajo po ashtu reflekton një përafrim të plotë në parimet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në zbatimin e pronësisë intelektuale.Hartimi i strategjisë është fryt i kontributeve të ekspertëve vendorë veçanti i kontributeve të ekspertëve nga zyra për pronësi Industriale dhe nga zyra ndërlidhëse e KE në Prishtinë përmes projektit EUAPO¹³⁵.

Të drejtat e autorit në Bashkimin Evropian

Legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të autorit është degë e një trupëzimi me të gjërë ligjesh që quhet Pronësi Intelektuale.Termi Pronësi Intelektuale i referohet përgjithësisht krijimeve të mendjes njerëzore.Pronësia Intelektuale Mbronë intereset e krijuesve duke ju dhënë atyre të drejtën e pronësisë mbi krijimet e tyre.Pronësia Intelektuale ka të bëjë me njesit e informacionit apo dijes që trupëzohen në objekte të prekshme në të njëjtën kohë në një numër të pafund kopjes në vende të ndryshme të botës.Pronësia nuk qëndron tek kopjet por ë informacionet apo dija që ato reflektojnë.Pronësia Intelektuale gjithashtu karakterizohet me kufizime,si kohëzgjatja e limituarë me rastin e të drejtës së autorit apo patentave.Rëndësia e Pronësisë intelektuale u njoh për herë të parë në Konventën e Parisit ‘Për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale’1883 dhe në Konventën e Bernës ‘Për Mbrojtjen e Punëve letrare e artistike’ 1886.

Burimet e së drejtës së autorit të Bashkimit Evropian

1. Konventa e Bernës
2. Konventa e Romës për Mbrojtjen e Interpretuesve,të Prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizatave Transmetuese
- 3.Traktati i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale OBPI
- 4.Marëveshja TRIPS
- 5.Konventa e Brukselit mbi Juridiksionin¹³⁶.

Mbrojtja e të drejtës së autorit është bërë,disa herë,objekt rregullimesh e debatesh edhe në planin ndërkombëtar.

Krahas Konventave Specifike,për të drejtën e autorit,janë realizuar edhe traktate me përmbajtje mjaft të gjerë e të ndryshme,në të cilat janë përfshirë klauzola të veçanta¹³⁷,që i

¹³⁵ <http://www.wipo.int/about/ip/en> - Strategjia për Pronësi Intelektuale 2010-2014 fq 11-MKRS Kosovë

¹³⁶ <http://www.zenelaj.com> Sulea Përmbledhje e të drejtave të autorit në BE.com

-atribuohen të drejtës së autorit. Konventa e Bernës për mbrojtjen e punëve letrare dhe artistike, e nënshkruarë në Bernë të Zvicrës me 1886, kjo konvent kërkon nga nënshkruesit e saj të njohin të drejtën e autorit të veprave, për autorët shtetas të njërit nga antarët e konventës së Bernës në të njëjtën mënyrë si një autorët i shtetas të vet. Konventa e Romës për Mbrojtjen e Interpretuesve të Prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizatave Transmetuese u nënshkrua me 26 tetor 1961, kjo Konvent kërkon që gjdo shtet antar të aplikojë atë në trajtim kombëtar të respektimit të të drejtave të cialt ajo ju akordon interpretuesve, prodhuesve dhe organizatave të transmetimit. Traktati i Organizatës Botërore të Pronësis Intelektuale OBPI u temelua në vitin 1970 e përskruar për të ndimuarë dhe për të siguruar që të drejtat e krijuesve dhe pronarëve të pronësis intelektuale në mbarë botën të jenë të mbrojtur dhe shpikësit e autorët ti shpërblenë për zgjuarsinë e tyre. Marrëveshja TRIPS ka hy në fuqi më 1 janarë 1995 është deri më sotë marrëveshja shumëpalëshe më e plotë në fushen e pronësis intelektuale. Konventa e Brukselit mbi Juridiksionin, u nënskrua në Bruksel me 27 shtator 1968 ,nga gjashtë shtetet antare të Komunitetit Evropian¹³⁸.

Aktet ndërkombëtare për të drejtat e autorit

E drejta e autorit, në kuadrin e të drejtave të parashikuara nga Deklarata e të Drejtave të Njërit dhe të Qytetarit. Në nenin 27 thuhet E drejta për të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore, të komunitetit njërëzor, për të gëzuar nga ato dhe pjesëmarrja, në progresin shkencor, apo të të mirave që rrjethin prej tyre janë të drejta të pamohushme të njërit, të cilat garantohen dhe mbrohen nga qeveritë e shteteve aderuese, në këtë deklarat të përgjithshme.

Konventa themeluese OMPI-t dhe UNESKOS-s 1967, Konventa e Bernës 1886, që ka dy shtesa, shtesa e Bernës dhe Akti i Parisit. Pastaj portokolli shtesë i Bernës 1914, Akti i Romës 1928, Akti i Brukselit 1948, Akti i Stokholmit 1967, Akti I Parisit 1967, Akti I Parisit 1971, Konventa e Madridit 1979 ku problemi fiskal dhe të ardhurat e nxjerrura nga ushtrimi i të drejtave pasurore të autorit janë ndër problemet e marra përsipër, për tu trajtuar nga Konventa e Madridit e vitit 1977-Konventa ndërkombëtare e Romës¹³⁹.

¹³⁷ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 300-shtëpia botuese Skanderbeg books, Tiranë 2009

¹³⁸ hppt. www. Zenelaj Suela Përmbledhje e të drejtave të autorit në BE.com

¹³⁹ Tutulani-Semini Mariana E drejta e autorit në Shqipëri fq 301-3008-shtëpia botuese Skanderbeg books, Tiranë 2009

- **Përfundimi**
- Pronësia intelektuale,përkatësisht e drejta e autorit gjinhnjë e më teper po tregohet si faktor ndikues në ekonomin e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit,prandaj respektimi i të drejtës së autorit është tejet me rëndësi.Përveq zhvillimit ekonomik zbatimi i të drejtës së autorit ndikon po ashtu në stimulimin e krijimtarisë kulturore dhe kreative. Pronësia intelektuale -të drejtat e autorit te ne janë një lami e re.
- Kjo rrjedhë nga shumë faktor,duke filluar nga ajo se egziston mungesa e kuptueshmërisë nga ana e shfrytëzuesve të veprave autoriale,në lidhje me detyrimet që këta shfrytëzues kanë ndaj atyre veprave.Pra shumica e shfrytëzuesve nga veprat artistike nuk e kanë të qart se për këto vepra duhet te paguhen të drejtat autoriale,pra te drejtat e patjetersueshme.Ndaj këtij problemi nuk janë imun as rishfaqësit e ketyre veprave si operatorët kablllovik,të cilët përpiqen të bëjnë gjithë qfarë është në fuqin e tyre për ti ikur këti obligimi.
- Egzistojnë edhe shume faktor që ndikojnë në mangsi të njohurive nga kjo fushë mirpo une mendoj se arsye kyqe konsiston në atë se në Kosovë edhe Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta që ka hyrë në fuqi në vitin 2012,ndërsa formimi i Task Forcës që meret me luftimin e falsifikimit dhe piratërisë në vitin 2013, gjithashtu edhe dy shoqatat kolektive Apik 2006 por që në praktik nuk u zbatua dhe Vapik 2012 që janë dy shoqata që merën me mbrojtjen e të drejteve të autorit,kjo është një periudhë mjaftë e shkurtër për vetëdisimin e qytetarve,informimin e tyre rrethë mundësis së realizimit të këtyre të drejtave.
- Gjithashtu edhe hartimi i strategjisë është fryt i kontributeve të eksperëve vendor,në veqanti i kontributeve të ekspertve nga Zyra Për Pronësin Industriale dhe nga zyra ndërlidhëse e KE ne Prishtinë përmes projectit EUAPO.Mirëpo nëse bëjmë krahasim me vitet paraprake në një aspekt duhet te jemi të kënaqur edhe me aq,edhe pse jemi ne fazen fillestare të kësaj lamie që është mjaft interesante, gjithmonë duke shpresuarë edhe për më mirë.

- Ndërsa sa i përket vendit fqinjë në rastin konkret Shqiperisë mendoj se janë në nivel më të kënaqshëm se ne me vete faktin se periudha kohore është më e gjatë sa i përket hyrjes në fuqi të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të lidhura me të. Ky ligj ka hy në fuqi me 1992 me përmirsimet në vitin 2005 Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, pra vetëdisimi është me i madhë te qytetarët e Republikës së Shqipërisë edhe pse jo sa duhet te ishin duke u bazuar ne periudhen kohore të hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- Mendoj se duhet vetëdisuar qytetarët sidomos autorët e veprave të tyre qoftë ato të artit, shkencës, muzikës etj, të mbrojnë dhe të kërkojnë të drejtat e tyre pasi ato mbrohen me Ligje të posaqme ndërsa sa i përket vetëdisimit të qytetarëve duhet njoftuar qoftë përmes mediave, qoftë përmes organizimeve të ndryshme se veprat e caktuara janë vepra të mbrojtura me ligj dhe se ato nuk duhet të përdoren pa lejen paraprake të autorit, e aq më pak të keqpërdoren të falsifikohen sepse një veprim i tillë bënë veprën penale e cila është e denueshme me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Siq jemi të informuarë edhe një nga kushtet të Bashkimit Europian është funksionalizimi dhe aplikimi sa më i qartë i këtij Ligji, dhe është edhe një arsye më tepër të ketë ndryshime tek ngritja e vetëdijes tek qytetarët në aspekt pozitiv.
- Gjithmonë duke u bazuar në praktikën e këtyre dy vendeve, dhe duke u bazuar në faktin se egzistojnë Zyrat përkatëse për të drejtat e autorit, në Kosovë Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuara, që vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Zyra Shqiptare për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të që vepronë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit mendoj se ofronë një lehtësim për qytetarët që ju drejtohen, sepse nga këto zyra mund te informohen rrethë këtyre të drejtave, si dhe të gjithë autorët dhe kuautorët mund te informohen mbi mundësin që ti drejtohen institucioneve përkatëse për të kërkuarë të drejtën e tyre që mbrohet me ligjet të veqanta mbi krijimtarinë e re letrare, muzikore, artistike etj.

- Këto Zyra luajn rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të autorit ,përmes licencimit dhe të mbikqyrjes së shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave,ngritjes së vetëdijes,ofrimit të informatave aftësuese lidhur me zbatimin e të drejtës së autorit,si dhe krijimin e raporteve të bashkpunimit me zyrat si motra nga vendet e rajonit dhe të BE-së.
- Sidoqoftë në kuptimin e përgjithshëm gjëndja e tanishme nuk është në nivel të kënaqshëm as nga institucionet përkatëse sa i përketë organizimeve rreth informimit të qytetarve,as nga ana sa jemi te interesuar te kemi infarmata ne si qytetar rrethë këtyre te drejtave.Shpresojë qe në të ardhmën e afërt do të ketë ndryshime në aspekt pozitiv,duke propaganduar me ane të metodave klasike,të takimeve,rrjeteve sociale,deklaratave për shtyp,paraqitjeve në Tv në formë informative si dhe në një të ardhme të afërt te fillojmë të përdorim edhe metoda të specifikuara te informimit me qëllim sensibilizimi.

Literatura e shfrytëzuar dhe e konsultuar

1. Abdulla Aliu-E drejta e autorit-Skript Prishtinë 2004
2. Mariana Tutulani-Semini,E drejta e autorit-shtëpia botuese Skanderbeg books Tiranë 2009
3. Mariana Semini,Paul Torrem,Mariana Dedi,Pronësia Intelektuale-shtepia botuese Kristalina-Kh,Tiranë 2005
4. Ligji mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta Republika e Kosovës,Ligji nr 04/L-065,30 Prishtinë 2012
5. Ligji mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të Republika e Shqipërisë/Tiranë 2005
6. Ligji për të drejtat e autorit 2006 Republika e Kosoves
7. Kodi Penal I Republikës së Kosovës hyn në fuqi me 1 janar 2013-Kodi nr.04/L-82,20 prill 2012
8. Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë-Tiranë,Qendra e publikimeve zyrtare,2010 ISBN 978-9928-01-020-9
9. Kodi I Procedurës Civile-cip katalogimi në botimin bk Tiranë.Qendra e publikimeve zyrtare 2007
10. Deklarata Universale e të drejtave të njeriut të vitit 1948
11. Konventa e Bërnes për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike 1886
12. Pakti Ndërkombëtar për të drejtat Ekonomike,Sociale dhe Kulturore 1966
13. Direktiva me nr 93.83 CEE e Bashkimit European
14. Zyra Shqipëtare per të drejtat e autorit ZDSHA Republika e Shqipërisë
15. Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta ZDA Rrepublika e Kosovës
16. Strategjia për pronësin intelektuale/nga zyra për të drejtat e autorit-Kosovë
17. Strategjia kundër falsifikimit dhe piraterisë nga ZDA-Kosovë
18. Vendimi për krijimin dhe funksionimin e zyres shqipëtare per te drejtat e autorit Rep.e Shqipëris,vendimi nr.232,datë 19.04.2006
19. <http://www.SuelaZenelaj.com> Përmbledhje e të drejtave të autorit në BE.com
20. <http://www.esihasko.com> te drejtat e autorit.com
21. <http://www.wipo.int/about-ip/en/>
22. <http://www.vapik.org>

23.[http://www.menaxhimi kolektiv i te drejtave te autorit.com](http://www.menaxhimi_kolektiv_i_te_drejtave_te_autorit.com)

24.[http://www.te drejtat vetiake jopasure.com](http://www.te_drejtat_vetiake_jopasure.com)

25.[http://www.te drejtat e autorit/ndërgjegjsimi.com](http://www.te_drejtat_e_autorit_ndergjegjsimi.com)

26.[http://www.te drejtat pasurore te autorit.com](http://www.te_drejtat_pasure_te_autorit.com)